



D. u. Parlamenti i Kuvendit
e përgjegjësinë e dhënë nga sovani në ushtrimin deri në
përfundim të mandatit të deputetit të legjislaturës së IX.
30.04.2021

REPUBLICA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. 1081 prot.

Tiranë, më 30/04/2021

Drejtuar: **Z. Gramoz RUÇI**
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Kërkuesë: **Më shumë se 1/4 e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë**

Objekti: **Kërkesë për shkarkimin e Presidentit të Republikës**

Baza Ligjore: **Neni 90/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**
Neni 112 i Rregullores se Kuvendit

I nderuar Kryetar,

Ne një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë,

- Të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e dhënë nga sovani në ushtrimin deri në përfundim të mandatit të deputetit të legjislaturës së IX;

- Në linjë me fryshtësi dhe gërmësi e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 13.06.2019 sipas së cilës, *ndër të tjera, "Kuvendi i Shqipërisë i bën thirrje Presidentit të Republikës të reflektojë dhe rivendosë institucionin e Presidentit brenda kufijve të kompetencave të parashikuara në Kushtetutë dhe të parandalojë ndërmarrjen e veprimeve të tjera që janë në shkelje flagrante të Kushtetutës";*

- Në kushtet e nevojën emergjente për rivendosjen e menjëherëshmë të ligjshmërisë në institucionin e Presidentit të Republikës;

- Me qëllimin e vetëm atë të sigurimit të besueshmërisë të të gjithë popullit shqiptar te roli i Kreut të Shtetit, si një nevojë në një shoqëri demokratike dhe shtyllë thelbësorë e Shtetit të së drejtës;

- Të bindur në argumentat tona se Presidenti i Republikës gjatë periudhës para dhe gjatë fushatës zgjedhore 2021 ka shkelur rëndë dhe në mënyrë flagrante Kushtetutën, ka cënuar ndjeshëm besueshmërinë e qytetarëve në rolin e Kreut të Shtetit dhe nuk ka ushtruar detyrën e tij kushtetuese;

Në përputhje me parashikimet e neneve 90/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe 112 të Rregullores së Kuvendit paraqesim kërkesën si mëposhtë për shkarkimin e Presidentit, duke shpresuar në një shqyrtim sa më të shpejtë dhe të drejtë të saj nga ana e kollegëve deputetë.

I. HYRJE

Shqipëria është Republikë parlamentare ku Presidenti është udhëheqës simbolik i shtetit (Kreu i Shtetit) që kryen një rol përfaqësues dhe ekuilibruar në jetën e vendit.

Ai mund të cilësohet si një “*mediator institucionesh*” dhe si një “*pushtet asnjeanës*”, që nuk përfshihet në lojën politike, por qëndron mbi palët dhe nuk kryhen asnjë funksion aktiv në përcaktimin dhe realizimin e drejtimit politik.

Presidenti është një figurë e garantimit të unitetit kombëtar dhe duhet të moderojë konfliktet politike. Presidenti shërben si përfaqësues i kombit, si një entitet unik, duke promovuar imazhin dhe reputacionin e kombit të vet si brenda dhe jashtë vendit.

Në detyrat e tij përfshihen, *ndër të tjera*, përfaqësimi i vendit, kryerja e detyrave ceremoniale si një mishërim i autoritetit të shtetit dhe sigurimi i udhëheqjes qytetare si shprehje e identitetit, vlerave dhe aspiratave kombëtare. Funksionet e udhëheqjes qytetare të Presidentit përfshijnë aktet dhe kulturën patronizuese, duke mbështetur ose inkurajuar aktivitete bamirëse, duke vizituar komunitetet lokale, duke dhënë fjalime e mesazhe dhe duke prirur ngjarje kulturore. Duke qenë i lirë nga politika e përditshmë dhe nga partishmëria, por duke pasur një platformë kombëtare nga e cila mund të flitet, Presidenti vepron si ndërgjegje e kombit, duke folur për ata që janë harruar nga procesi politik. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton dhe i njeh Presidentit kompetencia specifike ushtrimi i të cilave udhëhiqet nga interpretimi rregullues i nenit 94 të Kushtetutës, sipas të cilit “*Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetencë të tjera përvëç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të*”.

Në kushtet që vija midis udhëheqjes civile dhe ndërhyrjes politike është e hollë, Presidenti sigurohet të mos japë komente publike që mund të interpretohen si të diskutueshme politikisht.

Deputetët firmëtar të kësaj kërkese më keqardhje vënë re se prej marrjes së detyrës së Presidentit të Republikës (*më poshtë referuar edhe si “PR”*) Z Ilir Meta ka tejkaluar, abuzuar dhe shkelur kompetencat e akorduara nga Kushtetuta.

Më së fundmi, në periudhën para dhe gjatë fushatës zgjedhore 2021 Presidenti i Republikës ka kryer në mënyrë të përsëritur disa akte dhe sjellje të cilat në vlerësimin tonë përbëjnë shkelje të rënda dhe flagante të Kushtetutës. Këto akte janë bërë shkak për ndasi sociale-politike dhe nuk i kanë shërbyer interesit të përgjithshëm të popullit shqiptar. Aktet e Presidentit konsistonë në sjellje dhe mesazhe publike të tij në kundërshtim me parimin e unitetit të popullit, të papajtueshme me cilësinë e Kreut të Shtetit, të cilat nuk përkijnë me rolin e tij përfaqësues dhe ekuilibruar në jetën e vendit.

Në abuzim dhe tejkalim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore si dhe në kushtet e shkeljes së rëndë dhe flagrantë të Kushtetutës, Z Ilir Meta para, gjatë dhe pas periudhës së fushatës zgjedhore të 2021, me veprimet, sjelljet dhe mesazhet e dhëna në publik nuk ka garantuar unitetin kombëtar, nuk ka moderuar konfliktin politik por përkundrazi e ka nxitur atë në termë të tillë të cilat sollën si pasojë daljen e organizuar të militantëve të partive politike në rrugë

duke terrorizuar qytetarët, duke kufizuar lirinë e tyre të lëvizjes si dhe lirinë personale, deri në kryerjen e konflikteve me arme dhe humbjen e jetës së një personi dhe plagosjen e disa të tjereve, përfshirë vënien në rrezik të jetës së efektivëve të Policisë së Shtetit. Deklaratat dhe mesazhet e intensifikuara të Presidentit në atë periudhë qartazi favorizojnë partitë opozitare dhe që njëkohësisht denigrojnë mazhorancën, duke cenuar kështu rëndë barazinë e konkurimit politik dhe duke shkelur paanësinë politike që Kushtetuta i ka veshur Presidentit të Republikës.

Përvec sa më sipër, të gjitha aktet e kryera nga Presidenti janë në kundërshtim me detyrimet ligjore për etikën e funksionarit të lartë publik dhe denigrojnë njëkohësisht figurën e institucionit të Presidentit të Republikës.

Me këto akte të përsëritura Presidenti ka shkelur rëndë detyrimet kushtetuese që burojnë nga neni 88/3 të Kushtetutës (Formula e Betimit), për të cilat është betuar t'i qëndrojë besnik që në momentin e parë të marries së detyrës së Presidentit.

Këto akte gjithashtu janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 82, 89 dhe 94 të Kushtetutës dhe përbëjnë shkaqe nga ato që parashikohen shprehimi isht në nenin 90, paragrafi 2 i Kushtetutës për shkarkimin nga detyra të Presidentit.

Ne, kërkuesit duke vlerësuar se aktet e kryera nga Presidenti janë shkelje të rënda dhe flagrante të Kushtetutës kërkojmë shkarkimin e tij në përputhje me nenin 90/2 të Kushtetutës. Kjo dispozitë shprehimi isht thotë: “(...) 2. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Propozimi për shkarkimin e Presidentit në këto raste mund të bëhet nga jo më pak se një e katërtë e anëtarëve të Kuvendit dhe duhet të mbështetet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij”.

Në analizë të kësaj dispozite kushtetuese rezulton se:

- Shkaqet për shkarkimin e Presidentit janë (i) kryerja e një shkelje të rëndë kushtetuese ose (ii) kryerja e një krimi të rëndë;
- Shkarkimin e Presidentit kanë të drejtë ta kërkojnë jo më pak se 35 deputetë;
- Vendimi i shkarkimit duhet të mbështetet nga të paktën 2/3 e anëtarëve të Kuvendit.

Shkaqet për të cilat ne kërkojmë shkarkimin e Presidentit janë kryerja prej tij e shkeljeve të rënda dhe flagrante kushtetuese siç analizohen në vijim.

II. RRETHANAT

Në mënyrë të detajuar gjenden të listuara bashkëlidhur kësaj kërkesë:

Përbledhje të mesazheve të Z Ilir Meta të shpërndara për publikun në periudhën para dhe gjatë fushatës zgjedhore 2021 nëpërmjet mediave print, online, audiovisuale me transmetim kombëtar dhe / ose rajonal, kryesisht në emisione më shikueshmëri të lartë në "prime time", (Lidhja 1)

Përbledhje e artikujve në media të rasteve të dhunës, terrorist dhe vetëgjyqësisë së militanteve të motivuar nga mesazhet e Presidentit si dhe deklaratat e institucioneve publike si KQZ (Lidhja 2).

Përbledhje e deklaratave dhe mesazheve të përsaqësive të huaja në Shqipëri (Lidhja 3)

Një ekstrakt i këtyre mesazheve gjendet përbledhur më poshtë:

28 Prill 2020: "Kërcënimi i fundit, që vjen përmes Tao Taos, nga bandat e Elbasanit dhe të gjithë Shqipërisë ka vetëm një përgjigje: Presidenti, gati për të firmosur Dekretin për mbrojtjen e Republikës! Shqipëria e Shqiptarëve! Vdekje tradhëtarëve!"

24 Prill (dita e heshtjes zgjedhore): "Të dashur Prokurorë dhe Gjyqtarë! Dëgjojeni mirë Presidentin e Republikës! Boll dëgjuat përsaqësuesin e Ndrangheta-s, Don Agaçion. Nëse jo, një pikë gjaku të derdhet nesër, por edhe një pikë loti, mjerë ju! Nesër duhet të jetë Festa e Demokracisë!"

24 Prill (dita e heshtjes zgjedhore): "Kriminelët janë kudo të rrezikshëm. Por më të rrezikshmit janë kriminelët e veshur me uniformë, janë ata që gjenden brenda sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë.

Prandaj thirrini mendjes, zbatoni ligjin, qëndroni larg ndikimeve politike, mos u bëni palë dhe ruani integritetin e detyrës. Përbushni detyrën pa asnjë vonësë dhe mos e detyroni Popullin t'ju arrestojë në flagrancë përmes ligjit, që Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar.

Presidenti i Republikës është gjithmonë me Kushtetutën dhe Sovranin.

Presidenti i Republikës është gjithmonë gati për të marrë përgjegjësinë për çdo Dekret në mbrojtje të Zgjedhjeve, Demokracisë dhe Popullit nga dhuna e oligarkisë!

Nesër duhet të jetë Festa e Demokracisë."

24 prill (dita e heshtjes zgjedhore): "Cfurget do janë të dielën nëse preket vota. Zgjedhje si të Shifikut dhe të Dibrës, nuk do të ketë më. Kjo histori ka marrë fund. Unë kam besim te shqiptarët. Të gjithë janë nisur drejt kutive të votimit, për të sjellë ndryshimin historik duke çuar Shqipërinë në rrugën e duhur"

20 prill: "Lidheni të Marrin shokë socialistë përpara se të ketë fatin e furgonit në Berat. Pse Meta u tha tre banditëve të "Rilindjes" të hynin në zyrën elektorale të PD dhe të qëllonin me armë Sekretarin demokrat? Me kë janë në këtë foto këta të katërt?

Me Metën apo me Kryebashkiakun e emëruar rilindas të Kavajës dhe shtabin e tij elektoral? Pse Meta e porositi Damjanin publikisht të përsërisë "tërmetin" e Dibrës në Vlorë? Pse Meta emëroi një ushtri patronazhistësh për të survejuar e shantazhuar 900 mijë qytetarë të Qarkut Tiranë?

Kush e prishi Marrëveshjen e 5 Qershorit nga tmerri i zgjedhjeve të lira?

Bablok, shqiptarët e dinë shumë mirë se ku kurdisesh ti për t'i përçarë shqiptarët në Shqipëri dhe rajon. Me qetësi dhe vendosmëri do e marrësh përgjigjen më 25 Prill nga të gjithë shqiptarët patriotë dhe europianë. Dhe në radhë të parë nga socialistët, që u shkatërrrove çdo vlerë pozitive dhe njerëzore.

Unë do shkoj në shtëpi kur ti të shkosh në psikiatri!

Shqipëria e shqiptarëve! Shqipëria në Bashkimin Europian!

Pas 25 Prillit kjo rrugë nuk ndalet më asnjë sekondë!

19 prill: “*Bravo qytetarëve të Beratit! Gjejini! Izolojini! Mos i toleroni!*

Nuk ka patronazhist, fuks dhe bandit, që mund ta ndalë Ndryshimin e Madh më 25 Prill!

”...Ngrehuni dhe bjeruni, korini dhe shtypini, katundar e punëtorë, që nga Shkodra gjer në Vlorë!” Me qetësi dhe vendosmëri drejt 25 Prillit!

13 prill: “*Gropat e zeza të inceneratorëve të mafies, i thithën 100 përqind paratë e planifikuara për financim nga taksapaguesit në 2020, ndërkoqë që pjesa tjeter e projekteve të menaxhimit të mbetjeve shfaqin realizim të dobët, që shkon deri në 9%.*

Prandaj 25 Prilli është referendum popullor kundër mafies së inceneratorëve e plehrave dhe kandidatëve të saj”

11 Mars: “*Kërkoj nga cdo qytetar shqiptar të tregojë respekt për veten dhe të besoje që fuqia e tij në demokraci është vota. Erdhi koha t’ja kthejme Edin, Lindës dhe Zahos, të cilëve ju mungon aq shumë”*

1 Mars: “*Detyra e qytetarit është të votojë. Unë i them qytetarit kush ju ka bërë presion me vendin e punës, kush ua ka blerë votën, ndëshkojeni me votë. Unë nuk kam asnjë interes, as se çfarë ka thënë dhe çfarë thotë njëri apo tjetri. Me 26 prill ma ndërroni emrin, ma vendosni si të doni një votë vidhet, do u pritet dora në sheshin Skënderbe, Kryemadhit të parit dhe të tjerat. Ky është një premtim i presidentit të këtij vendi. Nëse ka një bandit që do të tentojë të bëjë blerjen e votave si Shijak dhe Dibër do ua pres unë dorën, unë presidenti i Shqipërisë. Një votë të vidhet do të pritet një votë, nuk është në kuptimin figurativ.*

24 shkurt: “*Çkapja e shtetit është nevojë ulëritëse për të ardhmen europiane të Shqipërisë dhe për të ndalur shpopullimin e saj. Demokracia është kontrolli i sovranit mbi të zgjedhurit dhe jo zgjedha e oligarkisë mbi qytetarët dhe dhunimi i të drejtave të tyre kushtetuese. Dëshmova sot përballë qytetarëve të Republikës një rast flagrant të kapjes së shtetit nga sekti në pushtet me urdhër të Kryeoligarkut në pushtet, që ka kapur cdo institucion publik dhe tmerrrohet nga zgjedhjet e lira dhe rivendosja e llogaridhënieve demokratike.*

U bëj thirrje të gjithë deputetëve të reflektojnë për këtë koncesion sa më parë! ”

20 shkurt: “*Janë të shqetësuar nga mesazhet e Presidentit?! Le TË SHQETËSOHEN dhe le TË TMERROHEN të gjithë ata, të cilët mendojnë se do bëjnë “tërmët” në zgjedhje, si në Dibër, apo si në Shijak, qofshin këta qeveritarë, punonjës policie; qofshin banditë, gjithçka qofshin.”*

III. SHKELJET E RËNDA KUSHTETUESE

Presidenti i Republikës është kreu i shtetit shqiptar, garanti i Kushtetutës dhe përfaqësuesi i unitetit kombëtar. Për më tepër, ai nuk është kreu i një pushteti të veçantë (legjislativ, ekzekutiv ose gjyqësor), por koordinon me tre pushtetet; ose kryen veprime në lidhje me se cilën nga të tre pushtetet, sipas rregullave të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligjet specifike, për të cilat Presidenti i Republikës është garantuesi.

Këto funksione Presidenti i kryhen që në momentin e parë të ushtrimit të detyrës duke u betuar se do t'i bindet Kushtetutës dhe ligjeve të vendit duke mbrojtur institucionet, të drejtat e individëve, pavarësinë e vendit, në shërbim të të gjithë qytetarëve. Kështu, respektimi i Kushtetutës dhe ligjeve të vendit është zotim i marrë përsipër me përgjegjësi të plotë nga ana e Presidentit në çastin kur ai bën betimin përparrë fillimit të detyrës në zbatim të nenit 88/3 të Kushtetutës, që shprehimisht parashikon se: “*Presidenti fillon në detyrë pasi bën betimin para Kuvendit, (...): “Beto hem se do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të respektoj të drejtat dhe liritet e shtetasve, do të mbroj pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t'i shërbet interesit të përgjithshëm dhe përparimit të popullit shqiptar*”. Presidenti mund të shfojë edhe “Zoti më ndihmoftë!”.

Kushtetuta shqiptare përeakton vetem kompetencat dhe karakteristikat kryesore te organit: përfaqësues të “unitetit te popullit” – i pavarur nga shumica qeverisëse në parlament - dhe me rol *inter partes*.

Gjithashtu, sipas nenit 94 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetencë të tjera përveç atyre të njohura shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligj.

Në praktiken e vendeve me legjislacion të ngjashëm me sistemin kushtetues shqiptar, në ato raste që sjellja e PR rregullohet nga praktika e konsoliduar në vite e institucionit të PR në ushtrimin e fuqive presidenciale, parimi i zbatueshëm është ai i “*vetëpërbajtjes (self restraint)*” të Presidentit.

Në situata që mund të përbëjnë rrezik përendin dhe sigurinë publike, Presidenti në rolin e tij si përfaqësues i unitetit kombëtar mund të drejojë thirrje publike për qetësi, maturi, vetëpërbajtje apo dialog midis aktorëve të ndryshëm ose bashkëpunim me qëllim uljen e tensioneve.

Në cdo rast, doktrina kushtetuese pranon se “*aktiviteti politik*” i Presidentit nuk duhet te turbulloje ekuilibrin politik që është konkretizuar në formën e qeverisjes së miratuar prej legjislativit dhe duhet të ketë gjithnjë parasysh mazhorancën e zgjedhur nga populli. Kështu kushtetuta italiane në Nenin 89 parashikon një mekanizem specifik që kufizon ushtrimin e kompetencave presidenciale nëse aktet e PR janë në kundërshtim të plotë me ekzekutivin dhe shumicën parlamentare - dekreteret me valencë politike duhet të kundërfirmosen prej shefit të ekzekutivit. Kjo garanton mungesën e angazhimit politik të Kreut të Shtetit.

Në ato raste ekstreme që ndërhyrja e Presidentit mundet të justifikohet me nevojën për të garantuar Kushtetutën, ajo nuk mund të ketë objekt dhe qëllim tjetër, vecse të orientojë organet e tjera kompetente të zbatojnë Kushtetutën dhe ligjet e vendit.

Doktrina kushtetuese, sistemi kushtetues shqiptar, tradita e vendeve të ngjashme me sistemin tonë kushtetues, përjashton kategorikisht mundësinë që PR të mund të realizojë një drejtim **politik** të pavarur presidencial.

Z Ilir Meta në detyrën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë ka humbur rolin e përfaqësuesit të unitetit kombëtar dhe moderatorin e konfliktit politik, përkundrazi me mesazhet e tij drejtar publikut në periudhën para dhe gjatë fushatës zgjedhore ka treguar se linja e tij politike është e qartë, kundër maxhorancës në pushtet dhe popullit që atë e mbështet.

Në fakt, edhe në periudhën përpresa 2021, me sjellje të përsëritura prej 2017, kohë kur mori funksionin e Presidentit të Republikës, Z Ilir Meta ka kthyer me dekret një numër të konsiderueshëm të akteve ligjore të miratuara nga Kuvendi, ka rrëzuar propozime të kreut të ekzekutivit, ka refuzuar të emërojë anëtarë të sistemit gjyqësor, prerogativë e tij, ka refuzuar të pranojë betimin e një anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi për Gjykatën Kushtetuese etj.

Ky abuzim i hapur i kompetencave kushtetuese është tashmë kthyer në një “traditë të konsoliduar” të Kreut të Shtetit, prerogativë që Kushtetuta ia njeh Kreut të Shtetit vetëm në disa raste të izoluara - si psh kthim ligjesh, mosakordim shtetësie etj- mekanizëm që ka si qëllim konsolidimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, por në asnjë mënyrë si mjet i tij i presionit. Kjo sjellje abuzive ka krijuar një klimë të vështirë të funksionimit të institucioneve dhe dëme të konsiderueshme si në ekonominë e vendit ashiftu edhe në besueshmërinë e qytetarëve dhe partnerëve ndërkombëtarë te institucioni i PR në vecanti dhe në demokracinë shqiptare në përgjithësi.

Më konkretisht, hyrja e vonuar në fuqi e nismave ligjore, të ardhura si shkak i procedurave parlamentare të shqyrimit të dekreteve të kthimit të ligjeve nga PR konsiston në disa muaj deri në 1 vit. Kjo vonesë ka sjellë dëme të konsiderueshme të ekonomisë dhe financave të vëndit si dhe cënim të mirë funksionimit të jetës parlamentare të legjislaturës së IX. Me të njëjtin qëllim abuzues të kompetencave të njoitura nga Kushtetuta, PR uzuron kompetencën kushtetuese të Kryeministrat dhe Kuvendit duke mos dekretuar ministra, duke mos miratuar/dekretuar marrëveshje financiare në emër të Republikës; duke mos emëruar ambasadorë apo funksionarë shtetëror ushtarak apo civil, fakte këto të njoitura publikisht.

Gjithashtu, Z. Ilir Meta nëpërmjet akordimit pa asnjë procedurë të tituje dhe dekoratave apo dhënen e shtetësisë shqiptare për persona të cilët nuk përbushin kriteret ligjore apo nuk kanë kaluar nëpër procedurat e kontrollit ligjor tregon qartë abuzimin e Z. Ilir Meta me kompetencat kushtetuese të PR.

Në një rast flagrant të tejkalimit të kompetencave kushtetuese nga PR¹, Kuvendi i Shqipërisë, per herë të parë në historinë e demokracisë shqiptare, nëpërmjet Rezolutës së datës 13 pershor 2019 i bëri thirrje Z Ilir Meta të rikthente ligjshmërinë në institucionin e PR.

Me të njëjtën frymë të abuzimit dhe tejkalimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore si dhe në kushtet e shkeljes së rëndë dhe flagrante të Kushtetutës, Z Ilir Meta para, gjatë dhe pas periudhës së fushatës zgjedhore të 2021, me veprimet, sjelljet dhe mesazhet e dhëna në publik nuk ka garantuar unitetin kombëtar, nuk ka moderuar konfliktin politik por përkundrazi e ka nxitur atë në terma të tillë të cilat sollën si pasojë daljen e organizuar të militantëve të partive politike në rrugë duke terrorizuar qytetarët, duke kufizuar lirinë e tyre të lëvizjes si dhe lirinë

¹ Anullimi i datës së zgjedhjeve të pushtetit vendor në 2019 pak javë para fillimit të fushatës zgjedhore

personale, deri në kryerjen e konflikteve me armë dhe humbjen e jetës së një personi dhe plagosjen e disa të tjerëve, përfshirë vënien në rrezik të jetës së efektivëve të FA².

Mesazhet publike të PR një ditë para ditës së votimit, e rregulluar ligjërisht si dita e heshtjes zgjedhore në respekt të të drejtës kushtetuese të individëve për të zgjedhur, intervistat e tij të shpeshta, në mediat print, audiovizive apo mediat elektronike, mesazhet ditore në rrjete sociale, të mbushura me etiketimë ndaj figurave të larta shtetërore si Kryeministri, deputetë apo drejtues politikë të maxhorancës në qarqe të caktuara, mesazhe denigruese ndaj përfaqësuesve të lartë të misioneve diplomatike në Shqipëri si persona të shituar e të blerë nga mazhoranca apo Kryeministri, jo vetëm ulën besueshmërinë e Presidentit si përfaqësues i unititetit të kombit, si një entitet unik, i cili ka si funksion promovimin e imazhit dhe reputacionit të kombit të vet si brenda dhe jashtë vendit, por të publikuara edhe nga mediat e huaja cënuan rëndë të drejtat kushtetuese të individëve, imazhin dhe reputacionin e vendit dhe marrëdhëniet me partnerët strategjike të Shqipërisë si BE dhe SHBA.

Mesazhet e Z Ilir Meta në platformën e rrjetit social Facebook në periudhën zgjedhore 2021 kanë një intensitet të shtuar në raport me periudhat e tjera të vitit. Vetëm në ditën e heshtjes zgjedhore, në datë 24.04.2021 PR ka nxjerrë një seri mesazhesh denigruese, intimiduese dhe me anësi të qartë politike. Këto mesazhe në rrjetin social janë publikuar në një numër të kosiderueshëm mediash apo shpërndarë në rrjete sociale.

Intensiteti i shtuar i mesazheve dhe daljeve publike të PR gjatë periudhës para dhe gjatë fushatës zgjedhore 2021 gati të përditshme, konkurojnë me përfaqësuesit e lartë të subjekteve zgjedhore të cilët në atë periudhë e kanë të deklaruar aktivitetin e tyre në kërkim të votës për subjektin që përfaqësojnë.

Qëllimi i prezencës së shtuar të PR në media në këtë periudhë dhe sidomos agresiviteti i tij drejt drejtuesve të misioneve diplomatike, të organizatave ndërkombëtare, përfaqësuesve të lartë të shteteve të rajonit dhe jo vetëm, drejtuesve të forcave të policisë, anëtarëve të gjyqësorit dhe prokurorisë kanë shkeluar rëndë funksionin e PR dhe kanë cënuar procesin zgjedhor si dhe kanë cënuar marrëdhëniet me partnerët strategjikë dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në rajon.

PR në të gjitha daljet e tij publike ka kryer aktivitet partiake, në mbrojtje të interesit të një grupimi të individëve të cilët kryesisht i përkasin opozitës, duke ftuar popullin për të treguar maturi dhe “rrëzuar regjin në fuqi”. Përdorimi i termave si “banda në pushtet”, “banda e rilindjes”, etiketimi i përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave si “përfaqësuesi i Ndrangata”, cilësimi i nevojës për përdorim të votimit në datë 25 Prill si ditë referendumi që “përfundon bandën në pushtet” janë thirrje të hapura kundër mazhorancës qeverisëse, të ngjashme me ato të përdorura nga liderët e partive opozitare.

Sa sipër, qartësisht Presidenti ka kryer veprimitari të njëanëshme partiake, anti- mazhorancë, e cila bie ndesh me vullnetin e hartuesve të Kushtetutës shqiptare, të cilët në nenin 89 parashikojnë në një dispozitë ndaluese se “*Presidenti i Republikës nuk mund të mbajë asnje detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimitari tjetër private*”.

² Ngjarja e Elbasanit datë 20 Prill 2021

<https://www.asp.gov.al/drejtori-i-pergjithshem-i-policise-se-shtetit-deklarate-per-ngjarjen-e-djeshme-ne-elbasan/>

Siq mund te vihet re qartë, nga përbledhja e qëndrimeve dhe mesazheve te PR ne publik te cituara ne lidhjen 1, nga sjelljet apo prezencia e tij aspak "presidenciale", ne takime me persona te papërshtatshëm apo qartësish të pozicionuar ne kahe politike te qarta anti - mazhorancë, tregojnë se PR gjatë kësaj periudhe ka rrëzuar edo mundësi per t'u konsideruar si përfaqësues i "unitetit kombëtar", person apartiak, ne zhvillim te një veprimitarie publike kushtetuese, ne përndjekje te një interes publik te përgjithshëm, veprime këto ne kundërshtim me një dispozitë kushtetuese ndaluese.

PR ne daljet e tij publike ka intimiduar votuesit duke iu kujtuar se ai vetë apo "populli" do t'i "presin dorën", ai vetë apo *populli do t'i arrestonte vetë* jo nëpërmjet forcave të rendit apo institucioneve ligjzbatuese. Vargjet e thirrjeve luftatake dhe përdorimi i epiteteve të dhunës, vetëgjyqësisë janë mesazhe të qarta të Kreut të Shtetit drejt popullit, i cili prej tij priste shmangien e konfliktit jo nxitjen e tij, shmangien e dhunës jo motivimin e saj si një akt patriotik.

Kjo nxitje dhune dhe intimidimi i PR pak ditë para votimit ne kushtet e rritjes së rasteve të terrorit ne rrugët e Shqipërisë nga militantë të opozitës të armatosur ose jo që qarkullonin me mjete të partive të tyre politike, më qëllim të qartë kryerjen e akteve të vetëgjyqësisë së motivuara/justifikuara nga PR si akte qytetare dhe patriotike, të cilat cuan edhe deri ne humbje jete të një personi dhe vënie ne rezik të jetës për të tjerë, detyroi ambasadoren e SHBA ne Tirane t'i drejtohej publikisht dhe personalisht z Meta për të ndaluar këtë fushatë të nxitjes së dhunës dhe intimidimit të votuesve.

Mesazhi publik i Ambasadores³ dhe përgjigjja live e PR ne një interviste ne një kanal publik shqiptar Jane fakte të njohura botërisht ne Shqipëri edhe jashtë vendit (shih lidhjen 2 dhe 3).

Deklaratat, sjellja, statuset dhe mesazhet e PR ne periudhën para dhe gjatë fushatës zgjedhore 2021 janë të mbushura me një veprimitari intensive të PR, e cila nuk përndjek asnjë ushtrim të kompetencave të tij; asnjë orientim koordinues të organeve kompetente; asnjë qëllim të ligjshëm.

Sic rezulton nga rrethanat e parashtuara mësipër dhe konkretisht ne statusin e PR ne rrjetet sociale, ne intervistën e dhënë ne kanalin me transmetim kombëtar dhe kohë transmetimi "prime time" me shikueshmëri të konsiderueshme, PR qartësish të vend të mbështesë apo koordinojë punën e tre pushtetave i etiketon si "banda ne pushtet", "banda e rilindjes", fton popullin të kryejë referendum ne 25 prill që t'i japi fund pushtetit të bandave", fton popullin të ibëjë vetgjyqësi duke o kujtuar gjyqtarëve dhe prokurorëve se edhe ata do hetohen pas datës 25 prill.

Të njëjtat mesazhe, etiketë, epitete përdoreshin njëkohësisht nga liderë, kandidatë apo figura më popullaritet të partive opozitare, të cilat të artikuluara nga PR krijonin mesazhin e qartë të ndarjes së popullit ne ata të rilindjes apo jo, ata të pushtetit apo ata pa pushtet, ata që do hetoheshin pas datës 25 Prill, apo referendumi popullor që do i jepte fund pushtetit të bandave të përfundonte. Ne statusin e datës 24.04 2021 PR përfaqësues të Kryeministrisë, përfaqësuesi zyrtar i organit kushtetues të Këshillit të Ministrave, organi me i lartë i pushtetit ekzekutiv, si përfaqësues të grupimit të njohur mafioz italian Ndrangëta duke barazuar organin kushtetues Këshillin e Ministrave me një organizatë kriminale.

³ Mesazhi i Ambasadores së SHBA drejtuar z Meta ne rrjetin social Twitter

Presidenti ka cënuar rëndë barazinë e konkurimit politik duke shkelur kështu paanësinë politike që Kushtetuta i ka veshur Presidentit të Republikës

Presidenti në vend se të ishte neutral, i paanshëm dhe i pavarur nxiti konfliktin, zhvilloi aktivitet partiaq dhe tregoi qartë anësinë e tij për opozitën. Pavarësia e tij garantohet në mishërimin e parimit të përfaqësimit të unitetit të popullit, që nënkupton se Presidenti është i të gjithë popullit, pa iu referuar ndonjë orientimi politik të caktuar dhe se në vendimarrjen përkatëse nuk duhet të mbajë kahje politike. Me aktet e tij, Presidenti mbajti qartësisht anën e opozitës parlamentare pasi rezulton nga cdo dalje apo mesazh i tij publik.

Përvecse, Presidenti mbajti anën e opozitës dhe ai (presidenti) nuk përfaqëson më gjithë popullin, duke shkelur parimin e unitetit kombëtar, Presidenti mori përsipër të japë leksione demokracie që nuk ekzistojnë në asnje vend demokratik. Zgjedhjet janë për popullin e jo për partitë. Një shtetar i përgjegjshëm duhet të shqetësohet nëse cdo shtetasi i krijohet mundësia reale të ushtrojë në mënyrë efektive të drejtën e tij kushtetuese të zgjedhjes.

Kjo situatë pa diskutim që mund të përdoret nga subjektet politike për manovra që pengojnë zgjedhjet sipas interesave të ngushta partiake, që dëmtojnë interesin e përgjithshëm kombëtar dhe rrezikon në krijimin e precedentëve të rrezikshëm për demokracinë, ku zgjedhjet e lira dhe periodike janë një nga themelët e mirëfunksionimit të saj.


Me sjelljen e tij, mesazhet drejtuar publikut me qëllim përkrahjen e nxitjen e vetgjyqësisë, të cilat në Elbasan çuan edhe në humbje jete, terrorist, aktet e dhunës në rrugët e vendit në prag të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, mesazhet dhe sjelljet e intimidimit të votuesve, gjyqtarëve dhe prokurorëve, forcave të policisë, përfaqësuesve të lartë të misioneve diplomatike, cuan në cënimin e imazhit të Shqipërisë në botë dhe cënimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë në rajon dhe më gjerë.

Këto mesazhe, sjellje dhe akte të përsëritura të PR në abuzim, tejkalim dhe shkelje të kompetencavë të PR të njohura nga Kushtetuta konsistojnë në shkelje flagrante të Kushtetutes dhe Ligjeve të vendit, të cilat kanë denigruar dhe imazhin institucionit të Presidentit.


Konsekuecat e rënda të ardhura si rezultat direkt i këtyre shkeljeve, edhe në kuptim të vlerësimit të komisionit të posacëm hetimor të shkarkimit të PR në vitin 2019, përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe ligjeve të vendit të cilat cojnë në shkarkimin e Presidentit.

DEPUTETËT PROPOZUES:

1. Taulant Balla



2. Alket Hyseni


y 10
2021

3. ELISA SPIROPALI



4. ULISI MANJA



5. Lendife Trullo



6. Artemis Mala



7. EDUARD SUAQN



8. BURAR SECA



9. Aubert Tomasi



10. SADI VORPSI



11. Alta Xhaka Olladueller



12. Enon Bushiri



13. Adelina Rruste



14. Klodrena Sperber



15. Spartak Brako



17. Edling Boole Boole
18. Tatiana Rito Gyz
19. Ismet Bediray Güre
20. Robert Kulyay Steg
21. Phewit Bushay Bishay
22. Aurora Mora
23. Quiry Brose
24. Edmund Wee
25. Juris Gyrlys
26. Almira Khembulla
27. Ermenek Valikay (Felix) Cey
28. Peme Valie
29. Mirka Tumbang M.
30. Bernice Roerig
31. Colantua Grinomi Egenvamp
32. Quan Dusha

33. Florence Spaho ~~Jane~~

34. Mira Kravcik ~~Jane~~

35. Alice Kraemer ~~Jane~~

36. Andrel Khinsli ~~Jane~~

37. Evis Saesli ~~Jane~~

38. Adrienne Zuk ~~Jane~~

39. Antoinette Dhemis ~~Jane~~

40. Diana Bello Bello

41. Fete Velo ~~Jane~~ Folmar

42. Pandeli Magne ~~Jane~~

43. Farid Clappi ~~Jane~~

44. Lucy Housley ~~Jane~~

45. Bledar Laci Klem

46. Kreshnik Busekaj Ze

47. Nastikue Hysni VJ

48. Vellnet Dajiqith

49. Ejjo Hyska

50. Erolola Krasha Dmitrij

www.Oranेस्टV

Lidhja 1: Ilir Meta deklarata të anshme në periduhën para, gjatë dhe pas fushatës zgjedhore 2021 për

1. 1.03.2021 Ne emisionin “Frontline”/ News 24:

Ne rast se do t'i therrisja edhe njehere shqiptaret, si me 2 mars, kam qene i bindur, se nuk do t'i permbaja dot. Vetem referendumi i 25 prillit hap negociatat e anetaresimit me Bashkimin European.

Ndeshkon pa meshire me 25 prill keto qe ju ben presion me voten, keto qe tenton t'ju bleje voten, keto qe ju ka mashtruar. Nje vote po u prek, do pritet nje dore. Nese Rama fiton 71 mandate me vote te lire, une do jap doreheqjen nga posti i Presidentit. Nëse ai merr 71 mandate pa prekur votën e popullit unë kaloj në opozitë dhe marr drejtimin e opozites. Cilido që do guxojë në emër të popullit shqiptar të prek votën, do u pres dorën në emër të sovranit. Vetëm populli shqiptar me votën e tij, do të mbrojë demokracinë. Padise per Teatrin Kombetar do t'i shkoj deri ne fund, aferes se inceneratoreve do t'i shkoj deri ne fund.[Link](#)

2. 23.04.2021 Syri TV

“Tani live sapo me shkruajti Ambasadorja Yuri Kim per te mos permendur me cfurqet. I them Ambasadores amerikane live qe te mos marre me ne mbrojtje Edi Ramen. Meqe me dergoi live sms i them Ambasadores Amerikane mos e mbeshtet me Edi Ramen. Meqe jam transparent po ju them edhe nje fakt qe Ambasadorja Amerikane më ka kërkuar mua si President, një ditë para mbledhjes së KED-së të pranoj unë Adrian Dvorani. Këtë ajo e kërkoi jo në emër të Amerikës, po në emër të Edi Ramës. E perqafoj ambasadoren amerikane dhe i them boll nderhyre ne punet e brendshme te Shqiperise ne kete menyre te njeanshme. Deklarata e Yuri Kim eshte nje turp dhe e ftoj Ambasadoren te vije tani live ne studio bashke me Edi Ramen te ballafaqohemi para shqiptareve. Më 25 prill votojnë dëshmorët”

Nuk impresionohet Presidenti nga të gjithë lobistët që flasin anglisht dhe mendojnë serbisht për Shqipërinë. Shqipëria do të jetë e shqiptarëve. [Link](#)

3. 1.3.2021 ‘Frontline’ News 24

Une nuk merrem me punet e amerikes se kemi dike tjeter qe merret me punet e amerikes dhe gjithe botes. Une merrem me punet e shqiperise. **Sesa respekt ka ai per shba e tregoi kur ua hodhi ne fytyre marreveleshjen e 5 qershorit.** Une kam shume respekt per shba dhe une jam president i Shqiperise.

Amerikanet e Edi Rames Ilir Meta i kap per veshi, jo presidenti se presidenti eshte tjeter fuqi se ka fuqine e popullit shqiptar. E di ai sesi u flas une atyre kur ata nxijne dhe bejne maskarralliqe per llogari te Edi Rames. Dhe po i them qe te mos i permende me ata dhe genjeje as veten e as ata te mos e genjejne se do do ti dalin ata per zot po preku nje vote te lire se vota eshte e shenjte dhe do te jete e shenjte nga 25 prilli e per 100 vjet. [Link](#)

4. 11.03.2021 Te paekspozuarit – Ylli Rakipi

“**Ka ardhur koha te rikthejme nje sistem demokratik e insitucional ne vend te populizmit. Ky eshte nje regjim autokratik por jo serioz, se ka edhe regjime serioze. Të gjitha pushtetet i ka futur ai në xhep. Popullin nuk e fut dot në xhep. Kemi edhe rastin e Kirgistanit. Unë nuk besoj se zoti Rama mund të bëjë zgjedhje të ndershme.** S'ka bërë zgjedhje në parti. Shembuj

të tjerë nuk kemi c'të japid më. Rama eshte pjese e ketij komploti nderkombetar 20 vjecar kunder Shqiperise. Une e kam bere te qarte qe jemi ne nje beteje me nje mafie nderkombetare qe do te zhbeje Shqiperine. Askush në botë nuk del dot KUNDËR NJË POPULLI!

Unë kam kohë që luftoj kundër një mafie ndërkombëtare. As nuk më kërcet fare. Unë përsa kam dalë këtu jo vetëm që i dal zot vetes time, por edhe qytetarëve. Unë jam presidenti i botës për atë që kam të drejtë. [Link](#)

5. 12.03.2021 Meta live ne zyrat e FRD

I bëj thirrje gjithë opozitës që të zgjohet dhe të mos lejojë më asnjë prekje të rregullave të garës sepse do jetë vonë për të në rast se toleron sjellët e partisë bandë. Po i paralajmëroj policinë zbatoni ligjet! **Po i them kryepalacos së bashkisë bandë e di mos ju bind urdhrat e të çmendurit sepse ai do nxjerr kartelën e të sémurit psikik. E konsideroj si një përpjekje për grusht shteti.** Ti sjellësh një partie zyrtare, opozitare menjëherë pasi nënshkruan një marrëveshje me PD dhe partitë e Opozitës, për të marrë pjesë në zgjedhje, ti sjellësh një shtresë të tillë që nuk ka as vulë, as emër titullari për të mbajtur përgjegjësi nesër, të bëre me vrap e nxitim vetëm për të dhunuar fizikisht, por edhe psikologjikisht çdo forcë opozitare. [Link](#)

6. 15.03.2021 Syri TV: Cim Peka Live

Ky është një ballafaqim midis instalimit të autokracisë dhe kleptomanisë në këtë vend në shërbim të interesave të tjerëve, Rama është thjesht një peng i tyre. *Ministrja e Drejtësise sot duhet te ishte ne burg. Pergjigjen qe ende nuk e ka marre nga drejtësia do ta marre me 25 prill nga qytetaret e Tiranës.* [Link](#)

7. 20.04.2021 Intervistë TV1 Channel

Të gjithë ne e dimë që kryeministri është me probleme të mëdha mendore dhe psiqike, i evidenton edhe më shumë tanë nga tmerri i afrimit të ditës së të vërtetës. Ky karagjoz nuk ka se çfarë të dijë përmua se nëse do dinte diçka do kishte dalë në një debat, se e kam ftuar vazhdimisht. Ai do të frikësojë qytetarët shqiptarë. Patronazhistët janë duke u fshehur se kanë frikë se i kapin qytetarët dhe i thonë se përsë mi keni marrë të dhënat.

Ata qe kritikojnë janë servile dhe qenë qe dërgon neper televizione. Ata qe i mban me leket e inceneratoreve. **Ne rast se Rama fiton 71 mandate pa prekur votën, Rames do i jap dhe mandatin tim si president. ti marri te gjitha, ta marri dhe Presidencën, te veri atje një kukull.** Nëse populli do votoje Ramen unë skam pse rri dhe një vit kot. [Link](#)

8. 22.04.2021 Konference për mediat

Kjo është reforma në drejtësi e Edi Ramës që thotë Ilir Meta do ta ndryshonte reformën në drejtësi. O karagjoz e di bota lojërat që e bëjë ti me ca vagabond. Ne kemi ligjet e tua për ministrinë e brendshme për OFL e asgjë s'do preket. Ti që tha di çdo për ilir Metën. Ca di ti o rrugaç? O rrugash ti sillesh si lepur para Ilir Metës edhe para kriminelëve dhe horrave. Stë njeh Ilir Meta ty? Ti s'di ti për Ilir metën o vagabond. Boll mashtrove socialistët. **Nuk e ndryshon dot rezultatin e zgjedhjeve.** Martin lekë nga inceneratorët. A e keni parë raportin e mediave? Kush është partia e më e diskriminuar? **Burimi i tensionit në shqipërim është Edi Rama i cili ka kapur drejtësinë, do të blejë votat dhe ta bëjë gjithë Shqipërinë Shijak dhe Dibër.**

U bëj thirrje ndërkombe tarët të jenë më parimor dhe të reagojnë në kohë. Nëse sdo kishin pranuar shkeljen e marrëveshjes së 5 qershorit situata do kishte qenë më e mirë prej kohësh. [Link](#)

9. 01.04.2021 Abc News

Ilir Meta nuk pyet për horrat dhe gangsterët, nuk pyet për mafien ndërkombe tarë dhe as për diplomatë të korruptuar. Ilir Meta mendon vetëm për Shqipërinë dhe për respektimin e Kushtetutës. Madje edhe sot kam një paralajmërim të prerë për ta, në veçanti për mafien ndërkombe tarë, të bëjnë kujdes sepse Shqipëria nuk është një vend eksperimental. Kandidati me numrin 17-të në listën e PS-së për Tiranën duhej të ishte në burg e jo si kandidat për deputet, por është aty për të blerë vota. [Link](#)

10. 02.04.2021 Post

E kam paralajmëruar prej kohësh Qeverinë ende në detyrë të heqë dorë nga arroganca dhe të tërhiqet nga çdo vendim abuziv e jashtë procedurave ligjore ndaj investitorëve të huaj në vendin tonë. Vetëm për tekat dhe kapriçot personale të Kryeministrat, i cili e urren edhe lirinë e medias, tashmë Shqipëria është e detyruar të paguajë 110 milion euro. [Link](#)

11. 21.04.2021 Post

Edhe 4 ditë, që Sovrani të rimarrë në duart e tij sovranitetin e grabitur pabesisht dhe poshtësisht me zgjedhje si ato të Shijakut, të Dibrës, dhe me ato të paligjshme vendore. Të gjithë qytetarët të verifikojnë qendrat e tyre të votimit dhe me qetësi dhe vendosmëri të nisen drejt kutive të votimit në këto zgjedhje historike për vendin dhe kombin tonë për 100 vitet e ardhshme. **Asgjë nuk e ndal triumfin e vullnetit të Sovranit, që përmes Referendumit të 25 Prillit do ta përbysë Fuks-Shtetin e "Rilindjes" dhe do të rivendosë shtetin e së drejtës dhe Llogaridhënien.** Të gjithë ju zyrtarë, që nuk keni kartelë psiqike, mos e rëndoni pozitën tuaj duke shkelur ligjin dhe Kodin në ditët dhe orët, që vijnë. Të gjithë ju "të fortë", që po përdoren nga pushteti kriminal për presione dhe blerje votash, bëhuni gati se edhe pulat do t'u sekuestrojmë! Kush prek votën e 25 Prillit ka suluar sovranitetin e popullit dhe të Republikës së Shqipërisë dhe do trajtohet si armik i Republikës dhe Kushtetutës!

Kush shet votën, shet nderin e familjes së tij dhe nuk e meriton të quhet njeri dhe kurrsesi shqiptar. Përpara me qetësi e vendosmëri drejt qendrave të votimit, për Shqipërinë europiane, që ristarton fuqishëm më 25 Prill. SHQIPËRIA DO TË JETË E SHQIPTARËVE PËR-JETËSISHT! [Link](#)

12. 8.04.2021 Syri TV

Pyetje: A keni listuar emra qe do ua prisni duart?

Meta: Pa asnje diskutim qe kjo do te ndodhe, dhe mos u habisni kur kjo te ndodhe. Keni qenë tē paraljmēruar, nëse do t'i zgjasin duart drejt kutisë së votimit. **Besoj që këto 8 vite kanë qenë më se tē mjaftueshme që kemi tē bëjmë me probleme tē mëdha psiqike tē Edi Ramës.** [Link](#)

13. 12.04.2021 Post

Droga dhe trafiqet po ja nxijnë faqen Shqipërisë dhe po e rrënojnë. Këtë e thekson qartë drejtuesja e Europolit, e cila bën përgjegjëse "Rilindjen". Prandaj 25 Prilli është referendum popullor, që droga dhe trafiqet t'i përkasin tē shkuarës. [Link](#)

14. 16.04.2021 Intervistë për tv "6+1 Vlora"

"Qeveria po bën çdo gjë në këto zgjedhje për tē prishur standarde tē tyre, pasi po bën edhe palën edhe arbitrin në fushë. Por jam me besim se populli do marrë në dorë fatet e tij. Ka një tension artificial që vjen nga mazhoranca dhe kjo ndodh per shkak se ndihen pakicë. **Ajo kërkon tē imponohet përmes marifeteve, por do ta kete te pamundur.** Fushata zgjedhore që po zhvillohet nuk është e qetë. [Link](#)

15. 17.04.2021 Post

Dy foto tē pabesueshme nga Gjirokastra, që m'i nisi mik i shtrenjtë i demokracisë shqiptare, Martin Henze. **Asnjë shqetësim për psikopatinë tuaj ZOTI "RILINDAS", por nëse vërtet e besoni, që unë jam në garë për 25 Prillin, mos më detyroni tē hyj vërtet pasi do tē mbeteni pa grup parlamentar.** Pale po mora edhe Doktorin e Madh, nuk ka spital, që ju bën derman!

Ndaj respektoni Kodin Zgjedhor dhe boll e tepruat me shkelje se i nxitë faqen Shqipërisë para botës! [Link](#)

16. 18.04.2021 Post

Të dashur "patronazhistë", Mos e dëgjoni Kryefuksin se regjimi i fuksave ka mbaruar! Kryefuksi e di më mirë se kushdo tjetër. Nga djali i atij, që firmosi varjen e poetit Havzi Nela dhe për tē cilin u shpreh krenar, që ishte në anën e duhur të historisë, shqiptarët nuk mund tē presin asnjë reflektim dhe garanci për respektimin e shtetit ligjor dhe tē drejtave tē tyre kushtetuese.

Të gjithë me qetësi dhe vendosmëri drejt 25 Prillit! Referendumi për rivendosjen e Demokracisë do triumfojë shumë bindshëm! [Link](#)

17. 19.04.2021 Post

25 PRILLI, REFERENDUM KUNDËR FUKS-SHTETIT!

Punësimi nga Partia-Shtet i 10 mijë vetëve më shumë se një vit më parë në administratën publike, qëllimisht në prag të zgjedhjeve, është ndërhyrje flagrante në procesin zgjedhor. Këto vende pune, të cilat nuk kanë asnjë ndikim në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të Shqipërisë, paguhen me taksa e qytetarëve duke e rënduar edhe më shumë gjendjen e tyre ekonomike. Ndërsa **shteti i kapur, hap 10 mijë vende pune në administratën publike, pa asnjë vlerë, për të "rehatuar"** kryesisht patronazhistët, dhjetëra mijëra vende pune humbin në sektorët prodhues dhe mijëra biznese myallen dhe falimentojnë. Mirë që na survejojnë, por edhe t'i mbajmë me rroga për këtë! Prandaj 25 Prilli, është referendum popullor kundër **FUKS-SHTETIT**, i vënë tërësisht në shërbim të survejimit dhe patronazhistëve. Me votën e tij plebishitare Sovrani më 25 Prill, rivendos rendin kushtetues dhe shtetin e së drejtës. [Link](#)

18. 3.3.2021 Post

Shqipëria një hap më pranë autoritarizmit!

“Freedom House” e zbere Shqipërinë edhe më poshtë për vitin 2020, mes regjimeve HIBRIDE! Shembjen e Teatrit Kombëtar për interesa klienteliste, dhunimin e protestuesve dhe vrasjen kriminale të Klodian Rashës gjatë kohës së pandemisë nuk mund t'i mbulojë asnjë propagandë. Këto dhe të tjera ngjarje të rënda kurrë nuk do të amnistohen dhe për to drejtësia do vendoset në vend. **Përkeqësimi i të gjithë treguesve, veçanërisht shkelja mizore e të drejtave të njeriut, është një këmbanë e fortë alarmi për instalimin e shtetit policor, që e kam denoncuar prej kohësh.** Referendumi i 25 prillit 2021 është momenti historik për t'i dhënë një trajktore të re të demokracisë, shtetit ligjor dhe respektimit të të drejtave të njeriut, me qëllim përm bushjen sa më parë të kushteve të vendosura nga Bashkimi European. [Link](#)

19. 5 Mars 2021 Deklaratë për mediat e Presidentit të Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta

Liria e medias, e cila vazhdon të jetë nën një trysni të fortë nga pushteti e oligarkia, përbën një tjetër vijë të kuqe për Shqipërinë. **Çdo tentativë për të vijuar presionin ndaj medias, dhe nëpërmjet saj ndaj zërave kritikë të qeverisjes do të penalizojë përparimin e Shqipërisë drejt Europës.** Përdorimi i Shqipërisë si lavatriçe e parave të krimit përmes sektorëve të ndërtimit dhe pasurive të patundshme është alarmant. [Link](#)

20. 10.03.2021 Post

“Shqipëria, sipas raportit të fondacionit prestigjoz botëror “Heritage”, ka rënë nëntë vende më poshtë në renditjen për lirinë ekonomike, krahasuar me një vit më parë. Kjo rrëshqitje e frikshme në pikatë e lirisë ekonomike, është pasojë e drejtëpërdrejtë e cenimit brutal të të drejtave të pronësisë dhe mosfunkcionimit të sistemit gjyqësor. Ky raport thellësisht negativ konfirmon qëndrimet e vazdueshme publike, që kam shprehur edhe me dekrete, në mbrojtje të konkurençës së lirë. Ndaj është urgjente çapja e shtetit, Kuvendit, Qeverisë dhe e pushtetit gjyqësor nga oligarkët dhe interesat okulte. Referendumi i 25 prillit është një mundësi historike për të nxjerrë nga “intubimi” edhe lirinë ekonomike, krahas të gjitha lirive të tjera, që gëzojnë qytetarët në një vend plotësisht european,” [Link](#)

21. 5.3.2021 Post

Më 25 prill do të jetë vota e qytetarëve që do të vendosë dhe nuk do të jetë parimi ‘stalinist’, sipas të cilit nuk ka rëndësi se kush voton, por numërojmë ne. T’i frysmezojmë të gjithë qytetarët që fuqia e tyre në demokraci është vota e tyre. Vota e tyre zgjedh, vota e tyre ndëshkon, vota e tyre çon përpara demokracinë, e përmirëson dhe e forcon atë. [Link](#)

22. 17.03.2021 Leter KQZ për ngjarjet në Elbasan dhe zyrat e FRD

“Siç dhe jeni njohur me zhvillimet e fundit, përmes medias së shkruar, elektronike dhe vizive, situata politike parazgjedhore dhe klima e besimit ndërmjet forcave politike garuese në zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit, është cenuar rëndë. Përpos faktit të pasqyrimit në media të zhvillimeve të fundit në Tiranë dhe Elbasan, si President i Republikës, më duhet t’ju bëj dije mbi një situatë tërësisht të paligjshme, që ndodhi në selinë e Frymës së Re Demokratike, forcë politike kjo e cila u sulmua dhunshëm nga strukturat dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë”

“Ky sulm, që u organizua dhe ekzekutua vetëm pak ditë më parë, në datën 12 mars 2021, pas nënshkrimit të një marrëveshjeje të FRD-së me Partinë Demokratike dhe aleatët e saj për zgjedhjet e 25 prillit 2021, bie ndesh me të gjitha parimet demokratike të shtetit të së drejtës, bashkëjetesës që do të duhet të shoqërojë situatën, para, gjatë, dhe pas zgjedhore. **Ky sulm është një tjetër tregues i sjelljes tërësisht të papërgjegjshme dhe provokuese të mazhorancës, me qëllim dëmtimin e aktivitetit kushtetues dhe ligjor të kësaj force politike pjesëmarrëse në zgjedhje, por njëkohësisht edhe një dëshmi e përpjekjeve të saj sistematike për të minuar pluralizmin politik në vend”** [Link](#)

23. 19.03.2021 Deklarate

“Shqipëria zbatet, bizneset mbyllen, por administrata fryhet. Në kushtet kur ritmet dramatike të shpopullimit të vendit nuk i ndali as pandemia, kur situata ekonomike në vend rezulton më e rënda prej vitit 1991 dhe sipas të dhënave zyrtare të paktën 50 mijë vende pune janë mbyllur për shkak të COVID-19, fyrja e administratës shtetërore me punësimë të reja fiktive në prag të zgjedhjeve të 25 prillit ka përparuar ndjeshëm. Përdorimi i shtetit për qëllime elektorale është një tjetër dëshmi serioze dhe skandaloze e degradimit dhe e kompromitimit të reformës në administratën publike nga ana e Kryeministrit ende në detyrë. Më 25 prill jam i bindur se të gjithë qytetarët shqiptarë do të marrin pjesë masivisht në referendumin historik për të ndëshkuar njëherë e përgjithmonë degradimin e administratës, shpërdorimin e taksave dhe buxhetit, si dhe për të realizuar çapjen e shtetit” [Link](#)

24. 07.04.2021 Post, Aeroporti i Rinasit

Qeverisë së 1 Prillit do t’ia jap sot pasdite nga Vlora përgjigjen për çështjen e Aeroportit të Rinasit, si çështje shumë e rëndësishme e sigurisë kombëtare dhe e detyrimeve ndërkombëtare. Nëse është hapur Aeroporti i Vlorës, konferencën e shtypit do e bëjmë atje, por nëse jo, në një ambient tjetër të përshtatshëm për të cilin gazetarët do të njoftohen në kohë. **Ftohet dhe “Tërmeti” të marrë pjesë për shkak të përvojës së tij me aeroportet, fluturimet dhe jo vetëm.** [Link](#)

25. 10.04.2021 Deklaratë për mediat, Parku Apolonia Fier

Unë dje kam pasur një darkë me gazetarët e Vlorës informale. Pa përjashtuar asnë. Në darkë ka qenë te ftuar edhe Bujar Leksaj dhe Damian Gjiknuri. Zotin Damian e kam ftuar vetë pasi shpesh ai ka qenë I detyruar nga kryeministri për të shpifur ndaj takimeve në mia. Darka fokusin e kishte te transparenca e procesit zgjedhor dhe që të mos provokohet me shakara pa kripë që janë rrugaçeri. Të jetë I qetë edhe kryeministri. Deri në 26 Prill do jemi në Vlorë. Do jem ditën dhe natën. Janë të ftuar të rrinë me mua por çdo skenar do të jetë I papranueshëm. Të kuptojnë që në Vlorë nuk bëhet shaka. Unë e kuptoj pse e ka shqetësimin te Ilir Meta se **Ilir Meta bën gjithçka pér zgjedhje tē lira dhe tē ndershme. Dhe së dyti ai bën gjithçka pér tē shantazhuar opozitën. Diga kryesore pér tē mos përmbytur demokracinë ka qenë Ilir Meta. Kjo është një betejë finale dhe jo një betejë mes Ilir Metës dhe Edi Ramës.** [Link](#)

26. 16.04.2021 Post

Mosmbështetja e bujqësisë dhe e fermerëve, është e pafalshme dhe rrënja e braktisjes së fshatrave dhe e shpopullimit të vendit. **Edhe ato pak fonde "mjerane" tē përektuara nga buxheti pér Bujqësinë dhe që janë 10 herë më pak se fatura, që do t'i paguhet Bechettit, harxhohen në pjesën dërmuese pér spote, konferanca, panaire dhe "kotësira" korruptive.** Plot 60 përqind e parave të subvencioneve shkojnë pér pagesa jo produktive. Ndërsa vetëm "thërrimet" përfundojnë te fermeret, të cilët tē braktisur punojnë dhe prodhojnë me kosto 40% më të lartë se fqinjët në rajon. **Prandaj 25 Prilli, është referendum popullor pér shumë më tepër para dhe mbështetje pér Bujqësinë dhe fshatin.** [Link](#)

27. 19.04.2021 Intervistë me gazetarin Fatmir Popja, në televizionin "Skampa

"Po i shoh ne rrezik patronazhistet, sepse tani te gjithe janë vene ne kerkim te tyre. Une u bej thirrje qytetareve te ruajnë qetësinë dhe te degjojne mesazhet e mencuara te klerikeve tane fetare per te shkuar paqësish drejt 25 prillit. I shoh në rrezik patronazhistët, sepse njerëzit janë nervozuar shumë dhe po kërkojnë pikërisht ata. Çfarë mund tē bëj Presidenti kur sheh që ka akte dhune?! Çfarë duhet tē prese Presidenti? Që e gjithë Shqipëria tē jetë si Shijaku dhe Dibra? Kjo kurrë nuk ka pér tē ndodhur. Sot Mbrojtja e Atdheut është detyrat. **Mbrojtja e Atdheut është që tē gjithë qytetarët tē shkojnë tē votojë në 25 prill. Vota e tyre do sigurojë tē ardhmen, mbrojtjen e familjes dhe tē ardhmen e fëmijëve tē tyre. Vota e 25 prillit, do tē vendose ligjin dhe do mbrojë tē drejtat dhe liritë e tyre.** [Link](#)

28. 20.04.2021 Post

Të dashur nëna, baballarë, tē nderuar prindër dhe veteranë! Pavarësisht mundit, punës dhe sakrificave tuaja shumëvjeçare, pér herë tē parë pas më shumë se 20 vitesh, pagesat e pensioneve tuaja jo vetëm nuk u rritën por u ulen me 3,2%. Në fakt **ulja e vërtetë e tyre shkon rreth 5% me inflacionin sepse me paratë e sakrificave dhe kontributeve tuaja Fuks - Shteti do tē paguajë rreth 10 mijë patronazhistë që gjurmognë dhe "gërmognë" në jetën tuaj private dhe atë tē rreth 900 mijë qytetarëve të vendit.** Prandaj 25 Prilli është referendum edhe pér nënët dhe baballarët pér t'u çliruar nga abuzimi dhe nepërkëmbja e tē drejtave tē tyre. [Link](#)

29. 21.04.2021 Post

E përgezoj kandidatin Belind Këlliçi për kapjen në flagrancë të "rilindasve" të Vaqarrit, me ushqime dhe zarfa elektorale. **Opozita duhet të organizohet në mënyrën më të mirë për të parandaluar këto fenomene kriminale elektorale nga të cilat Kryerilindasi nuk shkëputet dot.**

As frikësimi dhe as blerja me zarfa dhe ushqime nuk e ndal Triumfin e Demokracisë dhe Sovranit më 25 Prill! Tolerancë zero për krimet zgjedhore! Ligj special për të përjashtuar përgjithmonë nga administrata vendore dhe qendrore zyrtarët, që konsumojnë krimet zgjedhore. [Link](#)

30. 23.04.2021 Post

Të dashur qytetarë, nëna, baballarë, motra, vëllezër dhe ju të reja dhe të rinj! Mbeten vetëm 48 orë, kur me votën tuaj ju do të përçaktoni vullnetin e Sovranit për drejtimin e vendit. **Të gjithë i kanë sytë te Shqipëria, vendi më problematik i rajonit dhe i Europës për zbatimin e standardeve të demokracisë dhe të zgjedhjeve.** Le të manifestojmë me qytetari dhe kulturë demokratike, vullnetin tonë të lirë për zgjedhjen e përfaqësuesve tanë në drejtimin e vendit. Sepse ato janë jo vetëm për 4 vite, por për të ardhmen e Shqipërisë dhe të shqiptarëve.

Prandaj, të tregojmë qytetari dhe kulturë demokratike në këto zgjedhje sepse ato duhet të jenë një moment bashkimi dhe feste e demokracisë. **Pjesëmarrja e çdo qytetari në zgjedhje është jo vetëm një detyrim qytetar, por edhe një akt i domosdoshëm patriotik.** [Link](#)

31. 06.04.2021 Post, Pasaportat diplomatike

Vendimi i pabesë për ndërprerjen e vlefshmërisë së pasaportave për Kombëtaren tonë të futbolit është i paprecendent dhe një hakmarrje primitive, për shkak të qëndrimeve kritike të disa futbollistëve për sportin. Është absurde të pengohen të mbajnë pasaportë, kuqezinjtë, që e futën Shqipërinë në Europë dhe na bënë të gjithëve krenarë, ndërkohë që vazhdojnë ta mbajnë atë faqezinjtë, që na lanë jashtë Europës dhe që po na turpërojnë. **Jam i bindur se më 25 prill 2021, do të përfundojë koha e vendimeve autoritare, arrogante dhe përjashtuese.** [Link](#)

32. 23.03.2021 Status

Ndërhyrja brutale mbi godinën historike të maternitetit "Mbretëresha Geraldinë", pa transparencë, në periudhë pandemie, është një tjetër atentat, në vijim të sulmeve barbare ndaj historisë, trashëgimisë kulturore dhe identitetit tonë kombëtar. Duke u solidarizuar me qëndrimin e Unionit të Arkitektëve, Urbanistëve dhe Planifikuesve të Shqipërisë për çështjen e ndërhyrjes mbi godinën e maternitetit "Mbretëresha Geraldinë", **u premtoj të gjithë shqiptarëve se pas 25 prillit në Shqipëri do të nisë epoka e referendumeve, për t'u dhënë të drejtën qytetarëve të vendosin vetë mbi të gjitha çështjet e rëndësishme me interes publik.** [Link](#)

33. 11.03.2021 Post

As pandemia nuk e ndali shpopullimin e Shqipërisë!

Me kurajë dhe me besim tek vota e lirë, me pjesëmarrje masive në zgjedhje, të çelim një epokë të re të ndërtimit të së ardhmes tonë të sigurt europiane, për të nxjerrë nga "intubimi" demokracinë, për t'i dhënë fryshtësuarje lirive dhe të drejtave të njeriut. **Do ta çlirojmë Shqipërinë nga thonjtë e oligarkëve, banditëve dhe arrogantëve!** Rrugë tjetër nuk kemi! Më 25 prill, o kurrë! [Link](#)

34. 11.03.2021 Post

Jam i sigurt se 25 prilli është dita e rizgjimit të demokracisë dhe do të jetë një FESTË E MADHE E DEMOKRACISË. Shpresoj, që të gjithë shqiptarët të bashkohen në këtë festë. **Kush kërkon t'jua prish festën, duhet të ketë parasysh se nuk do të ndiejë askush keqardhje që do të bëhet KURBANI i kësaj feste.** [Link](#)

35. 3.2.2021 Post

Jemi popull shqiponjash dhe shqiponjat fluturojnë vetëm lart. Marshimin kuqezi të nisur më 2 mars 2020 do ta çojmë deri në fund më 25 prill 2021. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket vetëm popullit. [Link](#)

36. 10.03.2021 Post

Shqiptarët janë një popull shqiponjash, që më 25 prill, do t'u jasin një leksion të fortë demokracie të gjithë atyre, që i konsiderojnë popull sorash dhe delesh. [Link](#)

37. 16.01.2021 Intervistë për Neës 24, në emisionin 'Kjo Javë'

Pyetje: Duke qenë se kjo është edhe intervista juaj e parë për vitin 2021. Cili është mesazhi juaj për shqiptarët, por edhe për politikën shqiptare?

Meta: Për qytetarët shqiptarë mendoj se, duhet të marrin të gjithë më shumë përgjegjësi. Duhet të vënë para përgjegjësisë politikanët e papërgjegjshëm, që kanë bllokuar zhvillimin e vendit, kanë dëmtuar situatën ekonomike dhe shoqërore të familjeve shqiptare, kanë vënë në pikëpyetje të ardhmen e këtij vendi, interesat kombëtare dhe publike. **Çdo qytetar duhet ta kuptojë që, ndryshimi është vetë ai, dhe ndryshimi fillon te pjesëmarrja e tij në zgjedhjet e 25 prillit.** [Link](#)

Meta status në Facebook: *Nga zgjedhjet e 25 prillit 2021, Shqipëria pret një PËRMBYSJE të madhe*, jo thjesht një rotacion. [Link](#)

38. 28.01.2021 Post

Meta ne Facebook: *Zgjedhjet duhet të ishin mbajtur me kohë. PËRMBYSJE DEMOKRATIKE më 25 PRILL 2021.* [Link](#)

Meta, Facebook: *Shqipëria nuk futet dot në thes nga një çetë me banditë, oligarkë dhe arrogantë. HARROJENI! Më 25 prill 2021, Shqipëria në dorë të shqiptarëve!* [Link](#)

39. 30.11.2020 në "Çim Peka Live"

Meta: *Problemi sot i Shqipërisë është 25 prilli dhe presidenti këtë e ka sot detyrën kryesore. 25 prilli vendos njëse Shqipëria do ecë drejt Europës apo do të bjerë në një greminë pa fund.* Pa zgjedhje të lira dhe të ndershme nuk ka asnjë shans apo mundësi për negociata. Të tjera janë muhabete kot. Kjo qeveri ka bërë çdo gjë për të bllokuar të ardhmen evropiane të Shqipërisë. *Të gjithë të shkojnë të votojnë. Kjo është një gjë që nuk mund të pranohet për popullin tonë. Të shkojnë të votojnë për Shqipërinë në Europë. Unë favorizoj rrëzimin e çdo tiranie.* [Link](#)

40. 22.11.2020 Post

Meta, Facebook: Sot mbushen 22 vjet nga Referendumi i 22 nëntorit 1998, miratimit të Kushtetutës nga populli. Neni 2 i saj, thotë: “Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket vetëm popullit”. *Vetëm populli do t'ja u kthejë legjitimitetin institucioneve përmes REFERENDUMIT të 25 prillit.* [Link](#)

41. 13.11.2020 Post

Ilir Meta Facebook: Më 25 prill 2021 do të ketë një referendum mbarëkombëtar për të rrëzuar këtë sistem oligarkik, që kërkon t'i kthejë qytetarët shqiptarë në qenie pa vlerë, të pafuqishëm dhe të pambrojtur. [Link](#)

42. 23.12.2020 Post

Ilir Meta, Facebook: *Koha për të refuzuar falsitetin e këtij sistemi, që nuk i dëgjon, nuk i përfshin dhe nuk ju jep asnjë mundësi të rinjve.* [Link](#)

43. 18.11.2020 Post

Ilir Meta, Facebook: O SOT, O KURRË! O JU, O KUSH TJETËR! Shumë i lumtur të prisja sot në Presidencë një grup të rinjsh profesionistë, të diplomuar me rezultate maksimale, në Shqipëri dhe universitete prestigjoze të botës, të cilët nuk e kanë braktisur Atdheun, duke vijuar të jalin kontributet e tyre në fusha të ndryshme. *Referendumi i 25 prillit 2021 është rruga më e sigurtë për të realizuar këtë objektiv të përbashkët.* [Link](#)

44. 8.10.2020 Postime në Facebook

Meta në Facebook: Gëzuar 8 Dhjetorin 1990! **KOHA PËR RESTART!** Për rivendosjen e Demokracisë dhe Llogaridhënisë! Për ta bërë Shqipërinë, si gjithë Europa! [Link](#)

Ilir Meta në emisionin “Përballë”: *Na duhet një “Restart”, sepse kemi thënë “E duam Shqipërinë si gjithë Evropa”!* Sepse kemi qenë pa përvojë, dhe kemi pritur edhe të tjerët që të na e bëjnë, dhe kemi menduar se të tjerët do ta duan Shqipërinë edhe më shumë se sa ne. Kjo është një histori që duhet mbyllur, Duhet ta bëjmë Shqipërinë si e gjithë Evropa. [Link](#)

Meta në Facebook: *Duhet ta bëjmë Shqipërinë si e gjithë Europa! I vetmi plan është: KOHA PËR RESTART!* "Plan B" nuk ka! [Link](#)

Meta ne Facebook: *Marrja pjesë në zgjedhjet e 25 prillit 2021 është një MISION PATRIOTIK.* [Link](#)

45. 10.10.2020 Post

Meta në Facebook: "Liri do të thotë epërsi e të drejtave të njeriut kudo. Mbështetja jonë shkon për ata, që luftojnë për të fituar ato të drejta dhe për t'i mbajtur ato. Forca jonë është uniteti i qëllimit të përbashkët. Për atë koncept të lartë nuk mund të ketë fund përveç fitores." - FRANKLIN ROOSEVELT. Të drejtat dhe liritë themelore nuk janë vetëm koncepte të shkruara në letër. Ato janë të drejta absolute, që kushdo, pa asnjë dallim, ka detyrimin t'i respektojë dhe mbrojë. *Sot më shumë se kurrë, duhet të jemi të gjithë bashkë, kundër çdo lloj tendencë autokratike, që vë në rrezik sistemin demokratik të vlerave dhe të drejtave që duhet të gëzojë çdo shqiptar. KOHA PËR RESTART!* [Link](#)

46. 20.02.2020 Post

Meta postim ne Facebook: Janë të shqetësuar nga mesazhet e Presidentit?! *Le TË SHQETËSOHEN dhe le TË TMERROHEN të gjithë ata, të cilët mendojnë se do bëjnë "tërmët" në zgjedhje, si në Dibër, apo si në Shijak, qofshin këta qeveritarë, punonjës policie; qofshin banditë, gjithçka qofshin.* [Link](#)

47. 18.02.2020 Interviste me gazetaren Beti Njuma

Meta: Ajo që ka ndodhur në Shqipëri është kapja e shtetit që ka ndodhur përmes ligjeve anti-kushtetuese të cilat kanë dalë mbi kushtetutën. *Premtini im si president edhe si një politikanë është që Shqipëria me referendumin e 25 prillit të hyjë në epokën e referendumeve.* Nuk duhet të besojmë tek këto institucionë as të zgjedhjeve, as drejtësisë askujt, institucionet që e garantojnë këtë është institucioni i popullit, referendumi. [Link](#)

48. 15.10.2020 Post

Ilir Meta, Facebook: Para 10 vitesh, realizuam një ëndërr, lëvizjen e lirë të shqiptarëve në Bashkimin European. Është koha për të bërë gjithçka për ta mbrojtur këtë arritje të madhe dhe për të bërë realitet aspiratën e çdo shqiptari për të anëtarësuar Shqipërinë në Bashkimin European. *Mos e braktisni Shqipërinë, por bashkohuni për ta bërë një vend të denjë european!* [Link](#)

49. 18.10.2020 Post

Ilir Meta, Facebook: Shembja e diktaturës së egër në fillim të viteve 90-të provokoi një eksod masiv. Tre dekada pas atyre ngjarjeve tronditëse, ritmet e shpopullimit të Shqipërisë janë sërisht dramatike sepse të gjitha standarde e qeverisjes në vend janë përkeqësuar. *Në emër të një kombi, që rrezikohet në ekzistencën e vet dhe që duhet të jetojë në trojet e veta ku flitet shqip, ku zemra rreth kuqezi dhe ku ka diell për të gjithë, është koha të bashkohemi të gjithë, brenda dhe jashtë Atdheut, për t'i thënë NDAL SHPOPULLIMIT TË SHQIPËRISË.* Të bashkohemi për familjet, që aq shumë e vuajnë ndarjen dhe vetminë! Të bashkohemi për rininë, që zëri i saj të dëgjohet në Kuvend, Qeveri, Bashki dhe në çdo institucion vendimmarrës! Të bashkohemi për zhvillimin e qëndrueshmërit ekonomik, për mirëqenies, për cilësinë më të mirë të jetesës, për vende të reja pune, për rroga më të mira, për arsim e shëndetësinë e merituar, për

të luftuar korrupsionin dhe kapjen e shtetit, për drejtësi jo selektive, për rend e siguri dhe integrim europian. **Është KOHA PËR RESTART! TË BASHKOHEMI PËR SHQIPËRINË!** [Link](#)

50. 24.12.2020 Intervistë në ABC News

Meta: 2 marsi absolutisht nuk është një betejë e lënë në mes. 2 marsi nuk është betejë e Metës. I ftoj shqiptarët që të kuptojnë greminën ku ka rënë shteti, ku janë rrëzuar edhe të drejtat e tyre. *Vendi është në krizë legjitimiteti, që zgjidhjen finale do e marrë nga sovani më 25 prill. Vëmendja duke ndalur te 25 prilli, sigurisht përveç pandemisë që është imediate. Pas 25 prillit do të garanton legjitimiteti i plotë i institucioneve.* [Link](#)

51. 22.02.2020 Post

Meta, Facebook: *Referendumi i 25 prillit do të përbysë me votë plebishitare klikën oligarkike, që rrjep dhe mashtron shqiptarët prej kohësh.* Tmerri i tyre është angazhimi publik i Presidentit të Republikës në mbrojtje të Kushtetutës dhe votës së lirë.

Shqiptarët do të votojnë më 25 prill 2021 për lirinë e dinjitetin e tyre, si asnjëherë më parë në këto 30 vite.

Më 25 prill 2021, Demokracia do triumfojë mbi oligarkinë dhe qytetaria mbi marrëzinë. Presidenti ka vetëm një votë, si çdo qytetar i këtij vendi dhe do të votojë kundër oligarkisë, që ka nëpërkëmbur Kushtetutën, ligjet dhe të drejtat e njeriut dhe që po mban peng të ardhmen europiane të vendit. [Link](#)

Meta me gazetarët në Vlorë: Më 25 prill Shqipëria do t'i takojë shqiptarëve dhe jo oligarkëve. Ky është angazhimi im nga Vlora. Pjesëmarrja do jetë historike. Shqipëria do ngrihet më këmbë. Shqiptarët e kanë kuptuar se fuqia e tyre është vota. Vota është e drejta e pronës, e drejta për punë, e drejta për të përballuar një jetë me dinjitet, për t'u përfshirë nga pikëpamja sociale dhe ekonomike. Çdo përpjekje për të demoralizuar shqiptarët është e dështuar. **Të gjithë të shkojnë dhe të votojnë për të ardhmen europiane të Shqipërisë, për dinjitetin e tyre, kundër shpopullimit të Shqipërisë.** [Link](#)

52. 28.10.2020 në Quo Vadis, Vizion Plus

Meta: Jam i bindur që në 2021 Shqipëria do të jetë shumë më mirë, ky vit ka pasur shumë sfida, jo vetëm me pasojat e tërmetit që ra para më shumë se një viti, por edhe me pasojat e pandemisë, edhe në aspektin e brendshëm, në planet e tjera s'mund të themi që ka qënë një vit arritjesh apo shumë pozitiv, jam i sigurt që të gjithë mezi e presim vitin e ri, për të punuar në këto drejtime e për të bashkëpunuar më shumë me njëri-tjetrin. *Shumicës së qytetarëve 25 prilli u duket larg. Uroj që 2021 të jetë vit ristarti për një Shqipëri të vërtetë europiane, më njerëzore, më solidare, jam plot besim që do të jetë i tillë.* [Link](#)

53. 29.01.2020 Post

Ilir Meta Facebook dhe Tëitter: Kur na ndajnë edhe 86 ditë nga zgjedhjet e shumëpritura të 25 prillit 2021, ju bëj thirrje të gjithë qytetarëve, të verifikojnë afatin e vlefshmërisë së dokumenteve të identifikimit. **Është thelbësore, që të gjithë qytetarët me të drejtë vote, të kenë mundësi të marrin pjesë në referendumin historik të 25 prillit.** Të votosh është e drejtë, por edhe një përgjegjësi e lartë qytetare. *Çdo neglizhencë në këtë drejtim penalizon të ardhmen europiane të vendit.* [Link](#)

Meta në Facebook: E përshëndes vëmendjen e pandërprerë të Partive Popullore Europiane dhe thirrjet e përsëritura të miqve të singertë europianë, të cilët mezi presin çeljen e negociatave për Shqipërinë. *I garantoj se mbi 99% e popullit shqiptar, mezi e pret hapjen e negociatave dhe se zgjedhjet e 25 prillit 2021 do t'i jepin fund injorimit të kushteve dhe plotësimit të standardeve për integrimin, duke e rivendosur vendin, plot energji të reja, drejt Bashkimit European.* [Link](#)

54. 6.02.2020 Prononcim për mediat nga Shkodra

Meta: S'ka asnjë shans dhe skenar për të rishikuar datën e zgjedhjeve pasi Shqipëria ka patur nevojë ulëritëse për zgjedhje prej kohesh dhe 25 prilli u vendos pas konsultimeve te bëra me konsensus. *I bej thirrje forcave politike te distancohen nga ata që kanë patur probleme me dekriminalizimin dhe te promovojnë figura te reja, me integritet. Populli shqiptar do jete i qarte për ti ndëshkuar me votën e lire ata që do marrin ne mbrojtje persona te tille thjesht për disa vota më shume. Ndëshkimi do jete tepër i rende, me vote mbarepopullore.* 25 prilli do jete referendumi për ri ngritjen morale, demokratike institucionale, dhe ekonomike për vendin tone dhe për shumicën e familjeve shqiptare që sot ndeshen me varfëri ne rritje. [Link](#)

55. 8.02.2020 Prononcim nga Korça

Meta: 25 prill referendum më i rëndësishëm se ai i vitit 94 sepse pas 30 vjetësh është vënë në diskutim e ardhmja europiane e Shqipërisë. *Në 25 prill duhet hequr pengesa kryesore e kësaj të ardhme europiane.* [Link](#)

56. 10.02.2020 Intervistë për emisionin “Faktor” në RTSH Korça

Meta: *Maxhoranca mos t'u japë mburojë politike kriminelëve që të hyjnë në parlament, të promovohen kandidatë me integritet.* Qytetarët meritojnë të përfaqësohen nga kandidatë me integritet dhe me vlera intelektuale dhe jo me ata që vijnë nga radhët e të ‘fortëve’, apo vetëm të biznesmenëve, dhe këta kryesisht gjithmonë të lidhur me pushtetin apo politikën. [Link](#)

Meta për tkurjen e LSI në një intervistë për RTV Korça: Është një çështje që i takon për t'u përgjigjur drejtuesye të LSI. Por kemi kohë që e dëgjojmë fjalën tkurje, që nga viti 2004 kur është krijuar dhe deri tani. Ndërkohë është parë që ka pasur një rritje të vazhdueshme të saj, por kjo nuk është çështja më e rëndësishme për mua. *Për mua është e rëndësishme që fushata për zgjedhjet e 25 prillit të bazohet në alternativa dhe jo në fake neës.* [Link](#)

57. 12.02.2020 Post

Ilir Meta, Facebook: *Populli nuk mund të tërhiqet më zvarrë nga një çetë banditësh, oligarkësh dhe policësh të korruptuar!* [Link](#)

Ilir Meta, Facebook: Për herë të parë, pas 30 vjetësh, Shqipëria është vënë para një pikëpyetjeje të madhe: Ose do rikthehet në shinat europiane ku ka qenë dhe nga të cilat ka dalë qartazi, ose do kthehet në një projekt lindor, ku ka qenë për më shumë se 50 vjet. *25 prilli është dita e RIVENDOSJES SË DEMOKRACISË.* [Link](#)

58. 13.02.2020 Dalje për mediat në Sarandë

- A do te ndikoje ne turizëm klima e rënduar e zgjedhjeve të 25 prillit?

Meta: *Nuk do ketë klimë të rënduar, por të përmirësuar, pas asaj ditë që unë e vlerësoj si referendum për të rivendosur demokracinë, rendin kushtetues, për të marrë vetë populli shqiptar me votën e tij fatet e veta, të familjes së tij dhe mbarë vendit tonë.* I garantoj që askush nuk do të prekë votën. U bëj thirrje të gjithëve të votojnë kundër çdo force politike që u bën presion qytetarëve me vendin e punës, apo me bukën e gojës. T'i ndëshkoje edhe më ashpër ata që do të ofrojnë para për vota. Sepse dinjiteti i çdo qytetari të Sarandës dhe Shqipërisë nuk mund të jetë kurrsesi i barabartë me vlerën në monedhë të një deleje, dhie, apo lope. Ne jemi një popull evropian që meriton demokraci. [Link](#)

59. 18.02.2020 Post

Ilir Meta, Facebook: Ndërsa çdo institucion shtetëror të ushtrojë funksionet pa cenuar dinjitetin dhe personalitetin njerëzor, si dhe të dëshmojë mbështetjeje e solidaritet me qytetarët, që po vuajnë në këtë kohë pandemie. *Çdo sjellje tjetër, që shkon deri në makabritet nuk do harrohet dhe nuk do të amnistohet, por do ndëshkohet rëndë në referendumin historik të 25 prillit 2021 dhe pas kësaj date.* [Link](#)

60. 20.02.2020 Post

Ilir Meta postim ne Facebook: Kënaqësi të takohesha sot me Komisioneren Europiane për Çështjet e Brendshme, znj. Ylva Johansson. Theksova rëndësinë, që do të ketë zhvillimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme përrugën europiane të Shqipërisë. *Pas zgjedhjeve të 25 prillit 2021, krimi i organizuar do të marrë goditje të prerë dhe Shqipëria do të kthehet në shinat e shtetit ligjor dhe të respektimit të plotë të drejtave të njeriut.* [Link](#)

61. 24.02.2020 Dalje mediatike mbi ligjin e koncesionit të aeroportit “Nënë Tereza”

Meta: *Ka edhe 26 prill. Një njeri që ka kartelë mjekësore kërkon rrethana lehtësuese. Po ata që s'kanë kartelë dhe janë paralajmëruar? Tani 25 prilli është gjëja më e rëndësishme. Problemat zgjidhjen me referendumin e 25 prillit.* A mund ti bëj një shërbim Kryeministrat që s'ma ka kërkuar? Do ti them pres del për të ndërgjegjësuar qyt të votojmë pa frikë që të kuptojnë që ajo është fuqia e tyre. Nëse ish partia që kam themeluar unë përfaqëson oligarkinë ta votojnë gjithë kundër. Nëse promovon banditë ta votojnë kundër. Jo mor zotëri s'janë dele shqiptarët. Ama që të bëhem Kore e Veriut dhe të brohorasim “bravo Shqipëria Socialiste”. [Link](#)

62. 25.02.2020 Post

Meta në Facebook: Duke e përshëndetur mesazhin e Komisioneres për të Drejtat e Njeriut, Dunja Mijatoviç bashkëndaj të njëjtin qëndrim se ky duhet të jetë viti për t'i thënë NDAL shkeljes së të drejtave të njeriut.

Me referendumin historik të 25 prillit, qytetarët shqiptarë kanë mundësinë të ndahen nga kjo epokë e errët e dhunimit të demokracisë dhe degradimit të shtetit ligjor.

PRANVERA SHQIPTARE PO VJEN! [Link](#)

63. 26.02.2020 Post

Ilir Meta ne Facebook: Duke nderuar kujtimin e viktimave të pafajshme Sabiha Kasimati, Tefik Shehu, Pjetër Guraziu, Jonuz Kaceli, Anton Delhysa, Haki Kodra, Gafur Jegeni, Myftar Jegeni, Manush Peshkëpia, Reiz Selfo, Qemal Kasaruho, Zyhdhi Herri, Gjon Temali, Petro Konomi, Niko Lezo, Pandeli Nova, Thoma Katundi, Mehmet Shkupi, Ali Qorralliu, Fadil Dizdari, Hekurran Troka dhe Lluka Rashkoviç, masakra e 26 shkurtit 1951, na kujton sot se demokracia duhet të mbrohet çdo ditë dhe me çdo sakrificë. Sepse “një popull që fle në demokraci, rrezikon që një ditë të zgjohet në diktaturë”. *Ndaj 25 prilli do të jetë Dita e Triumfit të Demokracisë dhe Fuqisë së Votës të çdo qytetari të Republikës.* [Link](#)

www.oranews.tv

LIDHJA 2: Përbledhje e artikujve në media të rasteve të dhunës, terrorist dhe vetëgjyqësisë së militantëve të motivuar nga mesazhet e PR si dhe deklaratat e institucioneve publike si KQZ apo PSH.

Prania e SMV (Struktura per mbrojtjen e votës) the veprimet terrorizuese të publikut

1. 25.04.2021 Shqiptarja.com

Dy persona, anëtarë të strukturës së vetëshpallur të PD-së për mbrojtjen e votës në Dibër janë vënë nën hetim, pasi kanë bllokuar automjetin e kreut të PS në Arras. Ngjarja u regjistrua mbrëmjen e djeshme, në orën 21:30, ku mësohet se Ferit Alia dhe Sokol Lata ndaluan dhe kontrolluan automjetin e Agron Cerrit, kreu i PS në Arras, me pretendimin se ai posedonte materiale që mund të ndikonin në procesin zgjedhor. [Link](#)

2. 23.04.2021 CAN.al

Artan Hoxha - “Prezantimi i pare në publik i SMV(Struktura per Mbrojtjen e Votes), nuk shkoi ashtu siç e kishin parashikuar ata, qe e ideuan dhe e krijuan. Të merkurën në mbremje, 10 pjestaret e SMV-se, ish-pjestare policie dhe te forcave speciale, perfunduan te arrestuar, ndersa tre furgonat fringo të rinj, u sekuestruan nga policia... Me poshte, në foto dhe video jane 3 furgonat e bardhe të SMV-se, duke patrulluar në rruget e Elbasanit gjate dites se merkurë 21 prill 2021, perpara se të ndodhët vrasja e Pjerin Xhuvanit dhe plagosja e 4 personave të tjere. Në fakt, këta furgona të markes RENAULT, prodhim i ri, jane marre me qira diten e marte me 20 prill 2021, ne një kompani ne Tirane. Furgonat jane marre në perdonim, për vetem 5 dite, nga e merkura e 21 prillit 2021, deri te henën e 26 prillit në mengjes, me kosto 60 euro në dite per cdo furgon.

Për 5 mjetet, jane paguar në total 1500 euro per 5 dite perdonim. Mjetet kane qene të pajisura me dokumentacion të rregullt, të targuara dhe me logo te PD-se. Prezenca e ketyre mjeteve në Elbasan, nuk eshte raportuar me pare, sepse vetem të merkurën paradite, ato jane pare në qarkullim në rruget e qytetit. Mesa duket, shfaqja e pare ne terren e “grupit të gatshem” të SMV-se, ka qene pikërisht me 21 prill 2021...” [Link](#)

3. 22.04.2021 Shqiptarja.com

Partia Demokratike ka pranuar se ka ngritur një grup të armatosur për të mbrojtur votën. Siç konfirmoi sekretari i përgjithshëm i PD Gazmend Bardhi, struktura është e pranishme në të gjitha qarqet e Shqipërisë dhe është e përbërë nga ish policë ose ish anëtarë të forcave speciale që veprojnë të armatosur. Zyrtarisht janë në zotërim të armëmbajtjes me leje si truproja, por në të vërtetë funksioni i tyre është tjetër gjë. Siç tregonë këto pamje të filmuara dje në mëngjes në Elbasan, anëtarët e Strukturës për Mbrojtjen e Votës (SMV) lëvizin nëpër qytete me tre furgonë që bëjnë patrullime të vërteta duke ndjekur një taktikë ushtarake dhe organizojnë deri postblloqe. Kjo foto, e bërë dje paradite në Elbasan, tregon ish forcën e Reneas Arbër Paplekaj i cili me një pistoletë në dorë ndalon për kontroll makinën e një kundërshtari politik pasi dyshon se ka bërë shitblerje të votave. [Link](#)

4. 21.04.2021 Newsbomb

Gazment Bardhi: Ne kemi angazhuar individë që e duan ligjin dhe Shqipërinë, për të mbrojtur Elbasanin dhe të gjithë vendin.

Nga vijnë këta?

Gazment Bardhi: Janë qytetarë të Elbasanit, por edhe individë profesionistë të ligjit pa asnjë precedent që janë vënë në shërbim të mbrojtjes së votës të qytetarëve të Elbasanit.

Pse këta persona janë të armatosur?

Gazment Bardhi: Nuk janë të armatosur, me përjashtim të zotit Papplekaj që e ka armën me leje nga Policia e Shtetit, asnjë tjetër nuk është i pajisur me armë, me armë kanë qenë ata që kanë ardhur në mbrojtje të krimeve zgjedhore.

Struktura që ju keni ngritur, për mbrojtjen e votës, mbi çfarë baze e keni ngritur?

Gazment Bardhi: Policia ka mbi një javë që është përfshirë në krim zgjedhor.

Artan Hoxha: Çfarë është kjo SMV-ja? Kjo duket si një strukturë paralele? Duhet ta sqarosh çfarë është kjo?

Gazment Bardhi: Kemi angazhuar SMV-në, nuk kanë ardhur nga qytete të tjera, kemi në çdo qytet. [Link](#)

5. 23.04.2021 Exit.al

Basha: “Ato janë struktura të cilat mbrojnë votën e qytetarëve në kushtet e rënies së shtetit. [...] Ne kemi marrë masat e plota për të garantuar për aq sa na takon si opozitë, zgjedhje të qeta, të lira dhe të ndershme dhe garancia më e madhe është pjesëmarrja masive”. [Link](#)

6. 24.04.2021 Panorama

Struktura e mbrojtjes së votës së Partisë Demokratike ka ndaluar tre automjete të njësisë administrative Vreshtas me rrëth 7 punonjës të kësaj njësie. [Link](#)

7. 24.04.2021 Balkanweb.com

Edmond Spaho: Mbremë rrëth mesnates, struktura e mbrojtjes se votes se PD ne fshatin Podgorie ndaloi tre makina te njesise administrative Vreshtas me rrëth 7 punonjes te kesaj njësie ne to. Dy prej makinave te markave Mercedes dhe öolksvagen te drejtuara nga Soni Laraku dhe Andi Zaqellari u larguan me force, kurse makina e trete e drejtuar nga administratori i Njësise Administrative Vreshtas Cezar Bezati dhe shoqerues Gerti Tabaku, u bllokua. Ne terren se bashku me ta ishte edhe kryetari I PS te Podgories dhe njekohesht zyrtar I tatimeve Korce Izmi Çoçka. Me insistimin e perfaqesuesve te PD u kerkua qe makina te kontrollohej dhe kjo u arrit ne oret e para te mengjesit te dites se sotme. [Link](#)

8. 22.04.2021 A2news

Albana Vokshi: ‘Në mungesë totale të institucioneve shtetërore, të shtetit për të mbrojtur votën, atëherë pranë PD-së janë krijuar struktura të posaçme të përbërë nga profesionalistë të fushës, të cilët vullnetarisht po punojnë në mënyrë të organizuar në shtabe për të marrë informacione, për të siguruar dhe denoncuar atë që quhet krim elektoral. Nuk janë të armatosur. Ato që kanë leje në mënyrë të ligjshme mund ta mbajnë armën. Unë në shtabin tim nuk kam njerëz të armatosur. Zoti Bardhi tha që ai që kishte armë e kishte me leje. Janë persona të organizuar

në Strukturat e Mbrojtjes së Votës. Ata bëjnë atë që shteti nën urdhrat e Ramës nuk po e bën”

[Link](#)

9. 23.04.2021 Asp.gov.al

Nga Oficerët e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër ka filluar procedimi penal dhe materialet hetimore janë referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër, për veprën penale “Thirrjet për armatosje ose marrje të padrejtë të komandës”, në ngarkim të shtetasit XH. M., kandidat për deputet i subjektit politik Partia Demokratike në qarkun Dibër. Kjo pasi gjatë një takimi elektoral në territorin e bashkisë Dibër, shtetasi XH. M. ka kërcënuar dhe ka bërë thirrje për të nxitur dhunë duke bërë prezent ngritjen e grupeve të gatshme me pretendimin e mbrojtjes së votës. [Link](#)

10. 22.04.2021 Abcnews.al

I ftuar në televizionin ‘6+1 Vlora’, Meta thotë se struktura për mbrojtjen e votës është një e drejtë legitime e opozitës, pasi sipas tij shteti është i kapur nga krimi. “Konfliktin ne Elbasan e stisi Edi Rama, i cili eshte i vetmi pergjegjes per ate situate dhe per te gjitha zhvillimet dramatike aty. Ngjarja e rende ndodhi ne pranine e policise, qe tregon se ky eshte një shtet i kapur nga krimi. Struktura per mbrojtjen e votes eshte një e drejtë legitime e opozites, ne kushtet kur Damiani ne vend qe te ishte sot ne burg eshte kandidat per deputet, kur struktura kriminale te Rilindjes vazhdojne me manovra per blerjen e votes dhe presione ndaj qytetareve.

[Link](#)

11. 22.04.2021 Kohajone.com

Alibeaj:” Në ka një mëkat në demokraci që nuk falet është vjedhja e votës dhe në rrafshin kushtetues është e qartë që çdo individ është i autorizuar nga kushtetuta për të mbrojtur votën. Nuk është për herë të përfshi fenomen presioni i shitblerjes së votës dhe presioni i administratës janë pjesë e gjuhës së përditshme politike dhe juridike. Ju sjell dosjet e famshme 184 dhe 339. Përdorimi politik i pushteteve dhe përdorimi politik i grupeve kriminale janë rreziku kryesor i demokracisë në vend. Në aspektin e moralit dhe së drejtës çdo njeri është i autorizuar të mbrojë pasurinë e vet që është vota. Ka dispozitat që autorizojnë qytetarin e ndershëm që vihen në dijeni për ngjarje të ndëshkueshme duhet të jetë ai që duhet të veprojë dhe ndërpresë çdo lloj veprimtarie kriminale. Për këtë arsy qoftë në rrafshin e së drejtës e moralit dhe ligjit çdo individ ka të drejtën e vet të mbrojë edhe të jetë sidomos në një situatë të tillë pasi fondet e krimit dhe korruzioni politik ia cenojnë. Çdo strukturë e PD, çdo simpatizant i yni dhe çdo njeri që është bashkangjitur opozitës dhe PD nuk kanë nevojë të instruktohen, sesa e kanë ndjesi të brendshme nevojnë për ndryshim dhe mbrojtur këtë votë masive që do derdhet në 25 prill nga çdo lloj kërcënim. Çdo shqiptar e demokrat e ka detyrim ndaj vetes e familjes për të mbrojtur votën e të ardhmen e tij”. [Link](#)

12. 21.04.2021 Report Tv

Gazmend Bardhi: Sot kur morëm informacione te sigurta, që një automjet pa targa po levizste në lagjen 5 Maj, e drejtuat nga një person i quajtur Met Daflaku, dhe në mes të ditës, në mes të lagjes, në mënyrë demonstrative, po shpërndante para në këmbim të votavedhe po mblidhëte karta identiteti, ne njoftuam strukturat e Mbrojtjes e Votës, te shkonin ta verifikonin. Strukturat

e Mbrojtes se Votes kanë në përbërje ish-punonjës të Policisë së Shtetit, të pastër dhe asnjë precedent penal. Pasi kjo njesi e verifikoi informacionin, ato kanë kërkuar ndërhyrjen e Policisë së Shtetit. Është njoftuar drejtëpërdrejtë Drejtori i Policisë Vendore Elbasan.(...) Ne prezencë të Policisë së Shtetit, në tentativë për të mundësuar largimin e makinës dhe personit që po blinte vota, një nga personat qe dyshohet te jetë Klement Xhaferri, por edhe shtetas të tjerë të paidentifikuar nga strukturat tona, ka nxjerr armën dhe ka qëlluar në drejtim të anëtarëve të Strukturës për Mbrojtjen e Votës. Aty kanë mbetur të plagosur Pavlo Vuksani dhe Emiljano Prenga, të dy ish punonjës të Policisë së Shtetit, pjesë e Strukturës për Mbrojtjen e Votave në Elbasan. Në këtë moment ka pasur të shtëna me armë mes palëve. Arber Paplekaj është pjesë e Strukturës për Mbrojtjen e Votës në Elbasan. Ai nuk është kriminel. As vrasës. Është ish-efektiv i Policisë së Shtetit dhe ish-shoqëruesh në Ambasadën Amerikane në Tiranë. Për shkak të punës që kryen në këtë moment disponon armë me leje nga Policia e Shtetit, tha Gazmend Bardhi. [Link](#)

21. 04.2021 [Tvklan.al](#)

Gazmend Bardhi: “Është një strukturë e shtrirë në të gjitha qarqet e Shqipërisë. Ne nuk kemi angazhuar një bandë tjetër, kemi angazhuar njerëz të ligjit, ish-efektivë të policisë të në mbrojtje të votës. Sigurisht pjesë e këtyre grupeve ka edhe qytetarë”. “Struktura e Mbrojtjes së Votës nuk lëviz në qytetin e Elbasanit, merr një informacion dhe shkon për të verifikuar informacionin me qëllim dokumentimin e krimit zgjedhor. Në atë rast krimi ka qenë duke ndodhur, prandaj Struktura e Mbrojtjes së Votës, ka bërë ndalimin e këtij personi dhe ka njoftuar Policinë e Shtetit nuk ka kryer asnjë veprim procedural dhe nuk ka lejuar që të prishet vendngjarja”. Nga përplasja e ndodhur këtë të mërkurë mbeten gjithashtu të plagosur dhëndri i Xhuvanit, Eltjon Bodinaku dhe një efektive e policisë, [Link](#)

13. 23.04.2021 [Euronews.al](#)

Xhelal Mziu: “Kemi ngritur grupet e gatshme, nga sot edhe në vazhdim çdo person i dyshimitë që lëviz në lagjet tuaja, mjafton një telefonatë dhe do ta pësojë njëlloj si ai i Elbasanit” [Link](#)

14. 07.04.2021 [Euronews.al](#)

Alfred Rushaj: “Struktura për mbrojtjen e votës ka një muaj që është ngritur si strukturë. Mbrojta e votës është parë jo vetëm si proces që nis me ditën kur një qytetar shkon për të votuar. Kemi detyrimin që së pari shkeljet t'i denoncojmë në organet kompetente tek KQZ apo SPAK. Drejtori i fushatës së PD se ditën e votimit do të ketë vullnetarët të angazhuar për të mbrojtur votuesit e djathtë por edhe komisionerët dhe vëzhguesit. “Mbrojtja e votuesve, komisionerëve dhe vëzhguesve ditën e votimit. Janë të gjithë vullnetarë që janë të gatshëm që atë ditë në qoftë se Policia e Shtetit nuk bën punë e saj, ta bëjnë ata punën e tyre” [Link](#)

Raportime të ngjarjeve terrorizues për publikun

1. 21.04.2021 TvkLAN.com – Vrasja në Elbasan

Qëllohet për vdekje në Elbasan Pjerin Xhuvani. Shkak përplasja mes militantëve të partive PS dhe PD. Mbeti i vrarë Pjerin Xhuvani, personi që shihni në këtë foto dhe ku u plagosën 4 persona të tjerë, mes tyre edhe Xhensila Sota, punonjëse e policisë. Të plagosurit e tjerë janë Pavlo Vuksani 50 vjeç, Emiljan Prenga 39 vjeç, të dy ish-punonjës policie dhe Eltjon Bodinaku, 32 vjeç. Ngjarja ndodhi rreth orës 14:00 të së mërkurës, kur 3 furgona që drejtohen nga disa persona pjesë e shtabit të Partisë Demokratike, kanë ndaluar këtë fuoristradë tip Benz-in ML, pa targa, me pretendimin se personat që gjendeshin në të shpërndanin para dhe u merrnin zgjedhësve karta identitetit. [Link](#)

2. 20.04.2021 Top Channel – Plagosje në Kavajë

Një person mbeti i plagosur brenda një zyre elektorale të Partisë Demokratike në Kavajë mbrëmjen e së hënës, por është jashtë rrezikut për jetën. Dyshohet se ngjarja ka ndodhur për një vend parkimi pranë zyrës elektorale të Partisë Demokratike ku edhe ndodhi ngjarja.

Edi Rama: “Plagosja e Kavajës e patolerueshme! Autori duhet çuar në pranga sa më shpejt! Politizimi i kësaj ngjarjeje është po aq i keq sa vetë ngjarja! Lulzim Basha duhet të bashkohet me mua për të mbështetur drejtësinë pa nxitur tensionin, ndërsa Ilir Meta duhet ta ndalë fushatën idioteske të tensionimit!”

Lulzim Basha: “Atentat kundër PD dhe Aleancës për Ndryshim nga një kryeministër që ai e di që humb, një njeri që ka humbur çdo lloj kufiri njerëz, tregojnë se këtij regjimi i ka ardhur fundit, kërkojnë të frikësojnë Kavajën dhe PD-AN, kërkojnë të na mbyllin gojën. Nuk na janë mbyllur gojën kurrë, do të marrin përgjigjen me votë të dielën nga Kavaja. Të tilla akte kanë shënuar akte të mëdha, tregojnë humbjen e toruan nga një grusht njerëzish që e dinë që shqiptarët janë të vendosur që t'i largojnë” [Link](#)

3. 19.04.2021 EuroNews - PD bllokoni rezervat e Shtetit Berat

Gjashtë ditë para zgjedhjeve, edhe në Berat ka tensione. Gjatë mbrëmjes së të hënës, një furgon me mallra ushqimore me kuti të ambalazhuara me logon e Rezervave të Shtetit, është ndaluar në rruge nga kandidati demokrat Tomor Alizoti dhe mbështetës të tij. Drejtesi politik i PD për Qarkun e Beratit, Tomor Alizoti denoncoi ngjarjen duke thënë se “Bashkia Berat shpërndan pako tek familjet e varfra në këmbim të dhënies së votës”. [Link](#)

4. 22.04.2021 Policia e Shtetit – Bllokimi i ushqimeve në Vaqarr

Specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Nr. 6 proceduan penalisht shtetasin F. H. (Florenc Hoxha), 46 vjeç, përfaqësues i një subjekti politik, për veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje”, sepse ditën e djeshme, shtetasit B. G. ka kërkuar ndihmën e Policisë, pasi disa persona i kishin bllokuar rrugën në lagjen Ibra, fshati Vaqarr, duke e kërcënuar të zbriste nga makina, me pretendimin se në këtë mjet kishte produkte ushqimore që përdoreshin në këmbim të votës. Nga veprimet e kryera ka rezultuar se ushqimet ishin përgatitur për t'uа shpërndare për iftar, besimtarëve mysliman që agjerojnë. Materialet procedurale do t'i

kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprime të mëtejshme hetimore. [Link](#)

5. 25.04.2021 Policia e Shtetit – Heqje e paligjshme e lirisë në Maqellarë

"Nga specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Dibër, filloi procedimi penal, dhe u referuan materialet procedurale në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, për veprat penale "Heqje e paligjshme e lirisë", "Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik", për shtetasit: F. A., 54 vjeç, S. L., 46 vjeç, banues në Dibër, (simpatizanë të një subjekti politik). Procedimi penal ndaj tyre filloi pasi në bashkëpunim me disa shtetas të tjerë në fshatin Arras, kanë kryer veprime në kundërshtim me ligjin, në drejtim të heqjes së paligjshme të lirisë, kundrejt shtetasit A.C. Këta shtetas kanë ndaluar dhe kontrolluar automjetin që drejtohej nga shtetasi A. C., (kryetar i degës lokale i një subjekti politik), dhe është mbajtur i bllokuar deri në mbërritjen e shërbimeve të Policisë, me pretendimin se ky shtetas, posedonte materiale që mund të ndikonin në procesin zgjedhor. Nga verifikimet e kryera dhe kontrolli i ushtruar nga grupei hetimor në automjetin që drejtonte shtetasi A. C., nuk u gjet asnjë send kompromentues në lidhje me procesin zgjedhor. [Link](#)

6. 25.04.2021 Can.al – Enkelejd Alibeaj rrethon shtëpinë e kryetares së PS, Fier

Kandidati për deputet i PD në Fier, Enkelejd Alibeaj dhe 19 militantë të Partisë Demokratike janë proceduar penalisht nga Policia. Kjo për arsy se një natë më parë kanë rrrethuar shtëpinë e kryetares së PS në fshatin ShënePremte. Denoncimi është bërë mëngjesin e sotëm nga zëvendëskryeministri Erion Braçë, i cili ka njoftuar se Alibeaj është kallëzuar në Polici. Së fundmi Policia ka njoftuar për nisjen e hetimeve ndaj Alibeajt e të tjerëve me anë të një komunikate për shtyp. [Link](#)

7. 24.04.2021 Oranews.al – Dibër, ndalohet punonjësja e postës

Policia e Dibrës njofton se ka nisur procedim penal në gjëndje të lirë ndaj një kandidati të PD-së dhe 4 simpatizantëve të PD-së të cilët akuzohen se kanë ndalur makinën ku udhëtonte punonjësja e Postës së Maqellarë. "Këta shtetas në mënyrë të kundraligjshme, në fshatin Burim, kanë kryer veprime në kundërshtim me ligjin, duke ndaluar dhe kontrolluar një automjet, që udhëtonte shtetasja F. M, punonjëse në Postën e Maqellarës, (me detyrë pagatore shpërndarëse e pensioneve) në Njësinë Administrative Maqellarë, me pretendimin se kjo shtetase po shpërndante para në këmbim të votave." Nga verifikimet e kryera dhe kontrolli i ushtruar i grupei hetimor dhe shërbimeve të Policisë në automjetin që udhëtonte shtetasja F. M., nuk u gjet asnjë send kompromentues në lidhje me procesin zgjedhor, informon policia e Dibrës. [Link](#)

8. 20.04.2021 Albatimes – Militantët e PD ndalojnë dhe ushtrojnë dhunë mbi qytetarët

Ka qarkulluar një video në faqen zyrtare të Sali Berishës ku konstatohet dhunimi i një qytetari nga një grup militantësh të cilët i përkasin Partisë Demokratike. Drejtuesi i automjetit shoqërohej nga një i moshuar. Vihet re se personat që kryen ndalimin e jashtëligjshëm, nuk disponojnë asnjë autorizim apo tagër ligjor të për të kryer një ndalim të tillë. Ata kanë ushtruar dhunë lektike dhe fizike ndaj drejtuesit të automjetit duke e goditur atë nga krahu i shoferit. Duket

qartë që bëhet fjalë për një ndalim të jashtëligjshëm pasi ndalime të tilla kryhen vetëm nga forcat e rendit pas një denoncimi përkatës. [Link](#)

9. 12.03.2021 Lapsi - Presidenti Ilir Meta sherr me policinë për zyrat e FRD-së

Sherr tek zyrat e FRD-së. Ka qenë vetë Presidenti Ilir Meta që ka përzënë policët e bashkisë me dhunë, duke i shtyrë e duke i bërtitur, siç duket në pamjet më poshtë. Policët Bashkiakë kishin ardhur me qëllim që FRD-ja të lironë zyrat. Në shkresën e nisur ndaj FRD-së kërkohet lirimi i zyrave, pasi do të bëhet sistemimi i stafit. Për të bërë të mundur lirimin e zyrave, policia bashkiake ka rrëthuar godinën dhe hequr edhe dritat. Meta ndërhyu pasi kjo lëvizje kishte prapavijë politike. Ai foli për mediat pas përzënies së policëve bashkiakë duke thënë që shkresa nuk kishte as vulë e firmë. [Link](#)

10. 25.04.2021 Euronews – Sherr mes militantëve në German, Mat

Sherr mes militanteve të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike në fshatin Gërmán të Matit, në perimetrin e QV 0949. Gazetari Benjanim Arifi raportoi se personat e përfshirë në sherr janë militantë të partive politike. Pas përlasjes fizike të tyre, menjëherë ka reaguar komisionarë dhe personat e tjerë që ndodheshin brenda perimetrit të qendrës së votimit, të cilët i kanë ndarë. Gazetari shtoi se ngjarja e sotme erdhi pasi përplasje të këtyre personave gjatë ditëve të fundit për blerje votash. Në këtë qendër votimi deri më tanë kanë votuar mbi 400 persona nga 816 që janë gjithsej të regjistruar. [Link](#)

11. 24.03.2021 Politiko - Sherr me grushte mes Luçiano Boçit dhe Gjergj Lucës

Ngjarja ka ndodhur disa ditë pas konfliktit me grushte në Labinot të Elbasanit, mes kandidatit për deputet të Partisë Demokratike Luçiano Boçi dhe biznesmenit Gjergj Luca. Kamerat e sigurisë filmuan momentin kur Boçi godet me grushte biznesmenin Luca. [Link](#)

12. 24.03.2021 Ballkanweb - Kandidatja e LSI-së, Elona Guri sherr me një qytetar

Në vendngjarje kanë shkuar shërbimet e Policisë të cilët kanë shoqëruar në ambientet e Komisariatit të dyja palët në konflikt për veprime të mëtjeshme. Grupi hetimor në drejtimin e Prokurorisë Durrës, vijon punën për sqarimin e rrëthanave dhe të shkakut të konfliktit. Elona Guri, e cila rezulton e para në listën e LSI-së në Durrës ka bërë një denoncim në polici, pasi pretendon se është konfliktuar në rrugë nga shtetasi me inicialet Ç.K. [Link](#)

13. 23.03.2021 Dosja.al - Digjet banderola e PS-së në Cërrrik

Një tjetër incident është shënuar në qarkun e Elbasanit. Kësaj herë, flamurit të Partisë Socialiste në Cërrrik i është vënë flaka. Pasi kanë pikasur gjithë çfarë ka ndodhur, zyrtarë të PS në zonë kanë njoftuar Policinë e Shtetit, të cilët kanë nisur punën për identifikimin e autorëve. [Link](#)

14. 14.03.2021 Shqiptarja - Përplasje fizike në Elbasan mes simpatizantëve të PS dhe PD

Festën e Ditës së Verës sot në Elbasan 'e vodhën'. Një grup militantësh, të organizuar dhe me flamujt e Partisë Demokratike në duar, në mes të kretimeve për këtë festë mijëra vjeçare, kanë zgjedhur ta shndërrojnë në një miting politik. Teksa Kryeministri Rama po kalonte në bulevardin kryesor të qytetit, ku ishte aty për të vizituar një panair agrobiznesi që ishte hapur

me rastin e 14-Marsit, mbështetësit e Bashës thirrën 'Rama ik', duke sjellë reagimin e të pranishmëve aty. Episodi degjeneroi në përplasje fizike dhe vetëm ndërhyrja e policisë mundi të shhangë precipitimin e mëtejshëm, duke shoqëruar në Komisariat disa persona. Pamjet janë transmetuar live edhe në Facebook-un e kryetarit të PD-së, Basha por ai më pas e fshiu videon. [Link](#)

15. 27.04.2021 TV Klan - Sherr ne KZAZ e Tiranes

Një sherr masiv dhe i dhunshëm ka ndodhur në KZAZ-në numër 30 në Tiranë mbrëmjen e kësaj të hëne. Policia ka njoftuar se në konflikt janë përfshirë disa vëzhgues me numëruesh e votave. Për shkak të kësaj ngjarje janë shoqëruar në polici 8 persona. Aktualisht ka ndaluar procesi i numërimit të votave dhe shërbimet e policisë vijojnë të kryejnë detyrën për ruajtjen e rendit dhe qetësisë. Siç duket edhe nga pamjet, në sherr janë përfshirë disa persona të ndryshëm. Gjatë konfliktit fizik janë përdorur edhe mjete e sende të forta. Për pasojë mendohet se janë lënduar disa persona pasi brenda KZAZ-së janë të dallueshme njollat e gjakut. Është dashur ndërhyrja e policisë që të bënte të mundur shuarjen e këtij konflikti. Menjëherë pas kësaj ngjarje në KZAZ-në 30 ka mbërritur edhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Ilirjan Celibashi. [Link](#)

16. 25.04.2021 ABC News - Sherr mes Komisionereve ne Tropoje

Konfliktohen komisioneret, Celibashi: Nderpritet procesi i votimit ne Lekbibaj, per shkkak te konfliktit ndermjet komisionereve, po marrim masat per ta zgjidhur kete situate. [Link](#)

KQZ – Deklarata

1. 24.04.2021 “Kjo Javë”, News 24 - Celibashi

Nuk janë ngjarje të mira, nuk janë, dhe e kanë efektin jo pozitiv për zgjedhet, kanë efekt negativ, por shpresojmë që në këto dy ditë mënyra sesi drejtuesit politikë i janë adresuar qytetarëve dhe mbështetësve të tyre të ketë ndikuar pozitivisht. Nga secila palë vijnë shqetësimë për palën tjetër. Njëra palë thotë që pala tjetë e sigurtë që po bën këtë gjë, pala tjetër thotë e sigurtë që ne s'po e bëjmë këtë. Nuk është absolute. Sa më sipër nuk janë gjëra të mira të ndodhin ato si rasti i Elbasanit. Sa më shumë afron ora e hapjes së procesit të votimit aq më shumë shtohen frikërat te secila parti. Asnjë palë nuk ndihet e sigurtë në atë që bën pala tjetër. Është e komplikuar. Ankesa kemi patur deri në momentet e fundit. [Link](#)

2. 5.04.2021 Twitter - Celibashi

Partitë politike, kandidatët dhe institucionet duhet të punojnë për të garantuar një fushatë zgjedhore të qetë dhe me mundësi për zgjedhësit që të njihen lirisht mbi ofertat politike dhe elektorale, si dhe të vendosin po lirisht për partinë apo kandidatin që dëshirojnë. [Link](#)

LIDHJA 3: Përbledhje e deklarative dhe mesazheve të përfaqësive të huaja në Shqipëri dhe organizatave ndërkombëtare

Reagime nga Ambasadat/Organizatat

1. 24.04.2021 Twitter – Yuri Kim

I met DP Chair Lulzim Basha today, same as I have met Pres Ilir & Meta PM Edi Rama in last 48 hrs. We reiterate US does not support any party or candidate. But we absolutely support the right of all Albanian citizens to vote freely & in peace. [Link](#)

2. 23.04.2021 Twitter – Yuri Kim

It is unacceptable for anyone to threaten that citizens will take up “pitchforks” on April 25 or if they don’t like the result of elections. These threats deserve condemnation. Those who incite violence will be held responsible for the results of their words and actions. Stop. [Link](#)

3. 23.04.2021 Twitter – House Foreign Affairs Committee

“We urge the Albanian authorities to ensure that voters are able to cast their ballots free from bribery, intimidation, and violence.” [Link](#)

4. 23.04.2021 Twitter – Yuri Kim

We urge SPAK to prosecute those violating the law & obstructing citizens’ right to vote freely & in peace. This includes those engaged in vote-buying, intimidation, or inciting violence. SPAK is actively investigating election crimes. [Link](#)

5. 23.04.2021 Twitter - Yuri Kim

Good to see clear apology out of Dibra. The violence inflicted on Elbasan this week cannot be justified, must not be repeated. The days of armed groups wearing the patch of any political party & “patrolling” the streets belong in the past - ugly past that all of us must reject. This incident should not be used to viciously attack one side or the other, to stir up emotion among supporters. Rather, it should cause all leaders to reflect on how they can lead this away from the past & toward a better future. [Link](#)

6. 21.04.2021 U.S Embassy Statement

We have seen the reports of violence in Elbasan today resulting in the death of one individual and injury to others. We call on law enforcement officials to investigate this incident quickly and thoroughly, identify perpetrators, and prosecute them to the full extent of the law. Those who engage in such violence must be punished. Ambassador Kim has asked President Meta, Prime Minister Rama, and Democratic Party Chairman Basha to exercise restraint – and to lead accordingly – pending investigation of this case. Our actions must be based on facts, not fear or rumor. With just a few days remaining before elections on April 25, we reiterate our statement of March 26 calling for leaders – those in office and those seeking office – to clearly reject violence. The U.S. Embassy will continue to monitor the situation closely. [Link](#)

7. 23.04.2021 Gregory w. Meeks dhe Michael McCaul

Kryetari dhe Anëtar i Komitetit të Punëve të Jashtme të Dhomës: Ndërsa Shqipëria përgatitet për zgjedhjet kombëtare në 25 Prill, ne i nxisim autoritetet shqiptare të sigurojnë që votuesit janë në gjendje të hedhin votat e tyre të lirë nga mitmarrja, frikësimi dhe dhuna. Ne gjithashtu presim që të gjithë udhëheqësit, ata që janë aktualisht në detyrë si dhe ata që shpresojnë të zgjidhen, të veprojnë në përputhje me normat demokratike edhe kur bëjnë fushatë të fuqishme. Miqtë e Shqipërisë në Amerikë mbeten të përkushtuar për të mbështetur një të ardhme demokratike dhe të prosperuar për popullin shqiptar. [Link](#)

8. 22.04.2021 Peter Zingraf

Ambasadori gjerman në Tiranë, Peter Zingraf, në intervistën ekskluzive për DW, lidhur me Zgjedhjet Parlamentare 2021 në Shqipëri, u bëri thirrje aktorëve të përfshirë në këto zgjedhje që të “kenë të quartë se retorika agresive dhe gjuha e urrejtjes nuk mund të kenë vend. Respekti i ndërsjellë dhe gatishmëria për dialog duhet të vleinë edhe në kohë fushatash zgjedhore. Zgjedhjet e lira, të drejta, transparente dhe paqësore janë pritshmëria e çdo shqiptareje dhe shqiptari.” [Link](#)

9. 22.04.2021 Twitter – Yuri Kim

I met PG Çela just now, will meet SPAK Chief Kraja soon, met Police Gen Director Veliu yesterday. US message: Those violating the laë & obstructing citizens' right to vote freely & in peace must be prosecuted fully. No special treatment. No exceptions. No one is above the laë. [Link](#)

10. 22.04.2021 Twitter - Soreca

Together with USAmbAlbania we met today CEC Cmssr. I Celibashi, to assess the general preparedness ahead of Sunday 25/4 elections. We stressed the importance to exercise the right to vote and the integrity of the voting & counting process. We recalled our expectation that all sides would avoid anticipation of results of Sunday's vote and would accept the results certified by the CEC. We reiterate again our call on restraint and avoidance of violence and inflammatory speech in the final steps of the campaign. The EU and its Member States will be present on E-day with 50 teams deployed in polling stations throughout Albania. The EU will stand by the side of Albanian people on Election Day. [Link](#)

11. 21.04.2021 Twitter - EU in Albania

The violent act that took place in Elbasan today must be rapidly investigated by the competent authorities, and clarity about responsibilities needs to be made and followed up thoroughly. We call for restraint and avoidance of violence, inflammatory rhetoric and hate speech in this crucial moment of the electoral campaign. [Link](#)

12. 19.04.2021 Twitter – Soreca

Good meetings in Elbasan today with Taulant Balla Gazmend Bardhi and Rudina Hajdari ahead of 25/4 elections, together with Amb. EliBarsacq and Peter Zingraf. We reiterated that it is essential that elections are free, fair and transparent, and that the campaign focusses on Albanian citizens' needs, free from attacks and intimidation. I will be back to Elbasan on E-

Day day together w/ my EU MS colleagues in a number of polling stations. These elections are important for the Albanian citizens, but also for the EU and for the future of Albania. [Link](#)

13. 22.04.2021 Facebook OSCE

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri vërejti me shqetësim incidentin e dhunshëm, që çoi në humbjen e jetës në Elbasan. Mendimet tona janë, së pari, për familjen e viktimës. Ne besojmë, fuqimisht, që fushata zgjedhore dhe përgatitjet e zgjedhjeve janë një mundësi demokratike e jashtëzakonshme, e cila nuk mund të njolloset me gjak dhe dhunë. Presim që policia dhe institucionet gjyqësore të Shqipërisë ta hetojnë plotësisht dhe ta ndjekin penalisht këtë krim të shëmtuar. [Link](#)

14. 23.04.2021 Ambasada e Italisë

Zgjedhjet duhet të zhvillohen në një klimë të qetë, pa përdorimin e dhunës. Në demokraci dita në të cilën votohet duhet të jetë një festë. Është çasti më i rëndësishëm dhe më i shenjtë pasi përfaqëson momentin në të cilin populli shpreh dhe vendos se prej cilit dëshiron të qeveriset. Për këtë arsy me vendosmëri aktet e dhunës të ditëve të fundit. Dhuna nuk përkon me demokracinë. Nuk është kjo ajo që duan dhe që kërkojnë shtetasit shqiptarë. [Link](#)

15. 25.03.2021 Misioni i Shteteve Anëtare të BE

Nisja e fushatës zyrtare është rasti që partitë politike dhe kandidatët t'i përqendrojnë debatet e tyre te programet përkatëse politike dhe reformat që synojnë të paraqesin për të përmirësuar jetën e të gjithë qytetarëve. Në këtë pikë, kujtojmë rëndësinë e dialogut politik konstruktiv dhe gjithëpërfshirës, siç ilustrohet veçanërisht në konsensusin e gjerë ndërpartiak që çoi në marrëveshjen e 5 qershorit të Këshillit Politik mbi reformën zgjedhore. E njëjta frymë duhet të frymëzojë një fushatë elektorale që bazohet në respekt të ndërsjellë, dialog dhe vetëpërbajtje, si dhe zhvillohet në një mënyrë paqësore, pa retorikë provokuese apo gjuhë urrejtjeje. Zgjedhjet transparente, gjithëpërfshirëse, të lira dhe të ndershme, si dhe respektimi i rezultatit të tyre, janë të rëndësishme për të siguruar legjimititetin e Asamblesë dhe qeverisë së re. [Link](#)

16. 15.04.2021 Ambasadori Italian, Fabrizio Bucci

Ne nuk bëjmë tifo për asnjë, as për njérën parti as për tjetrën. Ne bëjmë tifo për popullin shqiptar dhe Shqipërinë. Shqipëria meriton një qeveri të zgjedhur nga shqiptarët për të zgjidhur problemet e shqiptarëve që ta çojë Shqipërinë gjithnjë e më pranë Evropës. I takon shqiptarëve të mendojnë. Nëse pjesa më e madhe e shqiptarëve në zgjedhjet e ardhshme do të mendojnë se kjo qeveri ka bërë një punë të mirë, do të votojnë për qeverinë aktuale. Nëse jo, mazhoranca shqiptare do të mendojë të kundërtën do të votojë për një qeveri tjetër. Fushata Elektorale në Shqipëri më kujton shumë fushatën në Itali. Ka shumë pasion, vëmendje diskutime ku diskutimet verbale janë, por ajo që nuk shkon kurrë është dhuna. Zgjedhjet duhet të janë një festë. Zgjedhjet e 25 Prillit duhet të janë një festë për të gjithë sepse është festa e demokracisë sepse është momenti kur populli zgjedh se nga kush do që të drejtohet. [Link](#)

17. 14.04.2021 Twitter – Yuri Kim

US does NOT support any particular candidate or party. US supports the right of citizens to express their will through their vote. US warns those denying this right by buying votes or intimidating voters. [Link](#)

18. 14.04.2021 Twitter – US Embassy Tirana

"A kemi një kandidat të preferuar? Jo, nuk kemi. Nuk është ky pozicioni i Shteteve të Bashkuara. Ajo për të cilën vrasim mendjen janë institucionet dhe proceset. Dhe, prandaj nuk flas për këtë kandidat apo atë kandidat, këtë apo atë parti, por flas për rëndësinë kritike që ka që të sigurohemi që rregullat dhe proceset janë të ndershme, janë transparente, që fusha e lojës është e njëjtë për të gjithë, dhe që rregullat të zbatohen edhe në kohë, që të gjithë të kenë të njëjtat shanse Kjo është ajo për të cilën kemi interes" [Link](#)

19. 26.03.2021 Ambasada e SHBA

Ne u bëjmë thirrje të gjithë partive, udhëheqësve dhe votuesve që të përfshihen plotësisht dhe me përgjegjësi në ushtrimin e të drejtave dhe përgjegjësive të tyre. Nxism partitë të paraqesin ide dhe kandidatë që pasqyrojnë respekt për votuesit. Presim nga udhëheqësit që të shfaqin udhëheqësi, përfshirë edhe duke u siguruar që partitë dhe kandidatët e tyre sillen në përputhje me ligjet elektorale dhe standartet ndërkombëtare, duke refuzuar qartë dhunën dhe duke treguar se ata me të vërtetë do të ishin të denjë për të udhëhequr dhe përfaqësuar Shqipërinë. [Link](#)